

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 223, Maj 2022

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## NË GIMAJ TË SHALËS PËRURORHET KISHA E RE E "SHËN RROKUT" PAS 75 VJETEVE, NË BREG TË LUMIT VENDOSËT TRUPORJA E SHNA NDOUT

2

- REPORTAZH NGA MOMENTE HISTORIKE -

30 Prill 2022, ora 04:00 e mëngjesit, ditë e veçantë për fshatin Gimajt dhe zonën e Dukagjinit. Përpara Katedrales së Shën Shtjefnit në Shkodër, megjithëse nën shtet të butë ka një gjallëri të pazakonte. Në Katedrale nuk zhvillohet ndonjë rit apo ndonjë veprimtari tjetër, por dhjetëra automjete të ndryshme presin përpara saj të nisen në një udhëtim të largët të organizuar. Shiu në autonominë e vet kërkon të prishë punë të gjithëve, por ndoshta vete lutjet bëjnë, që më vonë rrezet e para të diellit tregojnë, se pranvera e vërtetë ka trokitur. ...



### DUKAGJINI, KARRELATË E SHKURTËR HISTORIKE

Përshëndetje në Shalë, në veprimtarinë "Shaljanët në emigrim për trojet e tyre"

6

Dukagjini ynë. Ky vend hyjnor i ngritur nga Zoti dhe jo i punuar nga dora e njeriut, me një popull fisnik në doke, dhe elitë në shpirtë, me gene të pastra Ilire, trashëgimtarë të denjë të Kastriotit dhe të Nënë Terezës, në shekuj të shekujve nuk njohu mbi krye kurrkënd tjetër përveç Zotit dhe keto male, që i bekoj këto vise me burra zemërgjerë e trima që ndër mote u sakrifikuuan për trojet e tyre, me martirë të fesë, që e flijuan jetën për Krishtin e Ringjallur; me nëna të përvujta dhe fisnike, me intelektual dhe akademikë të rangut të lartë shpirtëror, shkencor dhe filozofik, me pamjet plot madhni të bjeshkëve vigane, e të luginave ...

### UBI SPIRITUS DOMINI IBI LIBERTAS

(2 Kor 3,17)

Vëllazën dhe motra, i dashun Arqipeshkvi ynë, të dashun vëllazën meshtar dhe rregulltar, të nderueme auktoritete civile dhe ushtarake, mirë se ju ka prue i madhi Zot në këto troje orë-çueta të Dukagjinit e të Shalës, që Krishti i hatroi me dhantë të shumta shpirtnore dhe natyra i bekoj me këto pamjeve plot madhni, bjeshkë vigane, luginat të blera, gjallësi të ... e me kullat e bukura si tempujt e ... ve klasike.

Unë si frat i kësaj toke, nga trangu i gjakut prej Mollës së Shoshit e nga lisi i tamlit me gjak Shalët nuk due me ju folë për historinë e Dukagjinit, për luftat me Turgut Pashën, për kryengritjen antizogiste të v. 1926, për qëndresën e thukun antikomuniste e as me u ndalë me rreshtue dotet e gjalla të trashigueme brez mbas brezit; e as për gjuhën e pastër gegë të ruejtun me shumë devocion e fanatizëm; e as për përmvehtësitë antropologjike e cillësitë fizike të t'dukagjinanit; nuk due me folë as për pader Çiprian Nikën, dom Lazër Shelidinë ...

7

### UDHËTIM NË SHALË - SHALJANËT NË EMIGRIM PËR VENDLINDJENE TYRE

FOTOREPORTAZH

8

Një veprimtari shumë e bukur mund të thuhet madhështore, në respekt dhe mbështetje të këtij grupimi, i cili po vepron fuqishëm në krahinën e Shalës të Dukagjinit, par të ndihmuar në përmirësimin e jetës së banorëve, kënaqësinë e vizitorëve, zhvillimin e turizmit, ruajtjen dhe forcimin e traditave më të mira të kësaj zone e më gjerë.

Bekimi i kumonës së Kishës së Shën Rrokut në Gimaj pati një interesim të paparë të banorëve dhe ish banorëve, por edhe të shumë e shumë tjerëve nga Shala e zonat përreth. Kurrë kjo kodër e bukur, në krah që qytetit historik të Dakajve nuk kishte parë kaq shumë njerëz ...

### NËSE PO KËRKON ARTEMISËN, SHKO NË DELOS, NËSE KERKO MUA KI DURIM DHE MË LEXO

Manifestimi spektakolar poetik Ora e Maleve Rrozhajë, prill 2022 më mundësoi që të njihem me dy vëllimet poetike te poetes Zize e Pepshi, por jo me autoren, e cila sot na u për shfaq për herë të pare, në këtë celebrim letrarë në zemër të Shkodrës. Kolegu dhe mik i im Ali Daci më dhuroi vëllimet "Më janë Përzier atdhetë" dhe "Edhe vdekja, turpërohet nga dashuria". Mbi Ballinë lexova emrin Zize e Pepshi dhe i thirra të lutëm me ... di-hmo oj grua cila je ti?!

14

# NË GIMAJ TË SHALËS PËRURROHET KISHA E RE E “SHËN RROKUT” PAS 75 VJETEVE, NË BREG TË LUMIT VENDOSËT TRUPORJA E SHNA NDOUT

## - REPORTAZH NGA MOMENTE HISTORIKE -

30 Prill 2022, ora 04:00 e mëngjesit, ditë e veçantë për fshatin Gimajt dhe zonën e Dukagjinit. Përpara Katedrales së Shën Shtjefnit në Shkodër, megjithëse nën siten e një shiut të butë ka një gjallëri të pazakonte. Në Katedrale nuk zhvillohet ndonjë rit apo ndonjë veprimtari tjetër, por dhjetëra automjete të ndryshme presin përpara saj të nisen në një udhëtim të largët të organizuar. Shiu në autonominë e vet kërkon të prishë punë të gjithëve, por ndoshta vete lutjet bëjnë, që më vonë rrezet e para të diellit tregojnë, se praveza e vërtetë ka trokitur. Të bie ne sy organizimi deri në detaje. Ne, dhe shumë udhëtarë të tjerë nuk kemi organizuar, por krijojmë një bashkësi “te pavarur”, ka edhe nga ata që kanë ardhur nga vende të ndryshme të Evropës e deri nga ana tjetër e Atlantikut.

Dua të theksoj, që në fillim të këtij reportazhi se, radhe here ndodh që njerëzit të vetorganizohen në mënyrë kaq perfekte të pa imponuar, por me dëshirën e madhe për të marre pjesë në veprimtari të veçanta fetare, siç është ky i sotmi. Është për tu veçuar fakti se ka pjesëmarrës të besimeve të ndryshme, kjo tregon edhe njëherë se tek ne është vëllazëria fetare, e cila është në një nivel të larte bashkëjetesa fetare. Sot njerëzit më të nderuar janë ata, që kanë kontribuar në këto objekte kulturi, për të cilët shprehet nga të gjithë një vlerësim dhe respekt i veçantë. Dua të vë ne dukje një detaj disi të veçantë, pjesëmarrës në këtë udhëtim është një person ndryshe nga të tjerët. Quhet Ndoc Beshka, kryetar i shoqatës të verbërvë, i cili në këtë ditë shikon me sytë e zemrës. Për këtë çdo koment është i tepërt.

Është një udhëtim i këndshëm dhe mbresëlënës. Në fuoristraden tone së bashku me djemtë e mi, Mandon dhe Danielin kemi një tjetër të “paorganizuar”. Është nipi im Prof Dr. Zef Gjeta, i cili me pat shprehur dëshirën për të marre pjesë, sapo i kisha treguar datën, duke më thënë se:- “Nipi tek daja është mbret!” Kemi lenë mbrapa kthesat e forta mbi Okol, duke arritur në Qafen e T’thores, 1650m mbi nivelin e detit. Ndodhemi në një pike ku të duket sikur natyrën e shikojmë nga një planet tjetër. Panorama është magjepsë, megjithëse trashësia e bores anës rrugës vende-vende arrin deri në 2m lartësi, gjelbërimi i drurëve shekullor sapo ka filluar, rrezet e diellit mbi bardhësinë e bores bën një “rikoshete”, e cila të bën për vete.

### NJË RRUGË SHUMË E PËRFOLUR

Në mes të këtyre bukurive të natyrës të duket se, diçka të prish atmosferën. Rruga e përfunduar deri në Theth vetëm pak muaj më parë, ka filluar të shfaqë simpomat e para të “sëmundjes” së përgjith-

shme. Mua më shqetëson më tepër një diçka tjetër. Përpara përfundimit të kësaj rruge në mënyrë gati rastësore bana një investigim të “pa autorizuar” me një specialist të fushës, duke konstatuar lehtësisht një mori defektesh dhe abuzimesh, të cilat binin ndesh edhe me projektin, duke realizuar punime të një niveli të dobët, të cilat çojnë në shpërdorimin e fondeve publike. Këto binin ndesh, ndërkohë kur akoma edhe më keq Kryeministri reklamonte në media projektin për ta pasur zili. Unë duke marre shkas nga këto fakte ju drejtova atij me date 20.10.2021 duke i evidentuar thujtë të gjitha defektet dhe mangësitë deri në detaje, disa nga të cilat nuk janë konstatuar në ndërtimin e rrugëve të tjera, troç kishim të bënim me një cilësi të dobët dhe me një nivel të larte abuzimi, për rrjedhojë, sidomos gjate ngricave ato sjellin premisa për aksidente me pasoja të paparashikuara. Njëkohësisht me date 21.11.2021, pas heshtjes ju drejtova edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilin mund ta quaj me emërtimin “Vëzhgues i Lartë i Shtetit”. Përgjigjja e këtyre dy institucioneve ishte e njëjtë, në unison... “heshtje... vetëm heshtje”. Heshtja nga njëra anë dhe përfundimi i rrugës pa buje e lavdi më bën të mendoj se, unë kisha të drejtë.

Sapo lame mbrapa këtë rrugë shumë të debatuar, largohemi nga Thethi i bukur e piktoresk, me ato ndërtesa karakteristike dhe ndërtime të reja për tu pasur zili. Rruga vazhdon paralel me ujëvarën dhe kanionet e bukura të Thethit. Shpeshherë studiues dhe vizitore të ndryshëm, duke marre shkas nga këto bukuri natyrore të krahinës së Shalës, të luginës së Shalës dhe të gjithë Dukagjinit, por në mënyrë abuzive e disa prej tyre e perfrazojnë me Thethin duke “montuar” gjeografikisht dhe institucionalisht gabim territorin e Shalës dhe të gjithë Dukagjinit. Thethi, në vitin 1936 u lidh me Shkodrën me rrugë automobilistike, këtë fat nuk e pati pjesa tjetër e Shalës dhe e Dukagjinit, për rrjedhojë megjithëse kanë kaluar shumë dekada kjo pjesë ende nuk është eksploruar aq sa duhet, kryesisht për mungesë infrastrukture.

### OBJEKTE TË NDËRTUARA DHE KONTRIBUESIT

Për këdo që mëson se janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 13 objekte, përfshirë këtu edhe kontributin për pandeminë në zonën e Shalës, në një hark të shkurtër kohor, ndihesh mirë, sepse është një dhuratë njerëzore bamirësie me vlera të mëdha.

Objektet e ndërtuara dhe të rikonstruktuar janë:

- Kisha e “Shën Rrokut”, në Gimaj.
- Ndërtimi i Kumbones së re e Kishës së “Shën Rrokut”, në fshatin Gimaj.
- Truporja e Shna Ndout bashkë me

sheshin e vendvendosjes së saj.

- Ura e lagjes Xhaferaj, në Gimaj.
- Rruga e fshatit Vuksanajve.
- Rikonstrukcioni i Urës së Telit në Breg të Lumit.
- Ura e fshatit Marrnikaj, në Breg të Lumit.
- Rruga dhe ura e re në Nicaj, Shalë.
- Ujësjetllësi në Kodër Dedmaraj, në fshatin Gimaj.
- Restaurimi i dy shtëpive banimi, në fshatin Gimaj.
- Restaurimi i urës së Shalës.
- Ura e Pacajve, në fshatin Lekaj.
- Donacioni për pandeminë.

Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i këtyre objekteve është bërë i mundur me bujarinë se 160 subjekteve brenda dhe jashtë vendit, përfshirë këtu edhe pese kompani dhe bashkësi. Duhet vlerësuar, së pari kontributi i bashkësisë Hebre në New York, dhënë në nderim të humanizmit të shqiptareve, në Luftën e Dytë Botërore, të cilët kanë dhuruar mijëra dollarë. Do ta vlerësoja dy here kontributin për ato subjekte, të cilat kanë dëshiruar të mbeten anonim. Të gjithë këta duhen vlerësuar maksimalisht, sepse me zemërgjerësinë e tyre, bashkësia e Shalës ka përfituar aq shumë. Gjithsecili ka kontribuar sipas dëshirës apo mundësisë, por dëshiroj të veçoj disa subjekte më të rëndësishme, sipas kontributit:

- Vat Biga dhe Iliri (djali)-Gimaj-Kordinatori i shoqatës “Bajraktari” New York, kanë kontribuar jo vetëm për Kishën e Gimajve, por edhe për nëntë objektet e tjera në krahinën e Shalës.
- Gjovalin Biga (vëllai i Vates), është donatori i vetëm, i cili përveç ndërtimit të kumbones së Kishës ka kontribuar edhe në ndërtimin e kompanjelit.
- Gjin Markaj (Vuksanaj) ka kontribuar me vlera të mëdha për nëntë objekte.
- Nikolin e Anton Markaj (Vuksanaj) Kane rikonstruktuar për Urën e Shalës.
- Tonin Mrapshtia (Gimaj), ka kontribuar në pese objekte.
- Vladimir Lpeja (Gimaj), ka kontribuar në tre objekte.

Ka edhe subjekte të tjera, të cilët janë: -Nush Noli (Theth), -Nik Gjergj Gjela, -Lazer Biga (Gimaj), -Kujtim Plepi (Lekaj), -Ndoc Sukaj (Gjuraj), -Ndrek Tonaj (Vuksanaj), -Jozef Biga (Gimaj), -Gjin Deda (Gimaj), -Ded Prendaj (Nenmavriq), -Uvig Nike Gjela, -Tom Balbona, -Familja Funiçi, -Gëzim Plepi (Lekaj), -Gjovalin Gjela (Lotaj), -Gjergj K. Shpati (Lekaj).

### UDHËTIMI DREJT GIMAJVE, OBJEKTIV I TË GJITHËVE

Gimajt nga lindja shtrihen paralel me Lumin e Shalës. Nga perëndimi rreze vargmaleve të kufizuara me Malësinë e

Madhe dhe Pultin, në këtë vijë gjeografike gjenden Majat e Biges-2232m, e Lebunit-1585m dhe e Boshit-1650. Poshtë vargmaleve është bukuria e lëndinave të Bobnajve, Njemzes, Pepcit dhe Qafneses.

Sipërfaqja e territorit dhe popullsia e Gimajve është më e madhe jo vetëm nga 11 fshatrat e krahinës së Shalës, por edhe nga të gjitha fshatrat e Dukagjinit. Sipas studiuesve, është një vendbanim i hershem, që daton në harkun e viteve 1460. Pozicioni gjeografik, klima, resurset, fauna dhe objektet e veçanta historike, monumentet natyrore dhe fetare janë të harmonizuara si me dorën e shenjtë. Për këto dhe shumë të tjera, është folur e shkruar nga Teodor Ippen, Franc Nopça, Rose Lein, At Giuseppe Valentini deri tek At Benardin Llupi, At Marjan Prela dhe deri tek studiuesit e sotëm z. Gjovalin Gruda dhe z. Selman Sheme. Duhet veçuar një episod: Edith Durham veshi për here të pare xhubletën në shtëpinë e Nike Marashit në Radoje, ku nen dritën e pishës pranë oxhakut të kësaj shtëpie shkroi pjesë nga ditari i saj, por edhe duke ndihmuar gratë e shtëpisë në punët e përditshme. Ndërsa Franc Nopça përshkruan rrënojat e kështjellës së Gjytetit dhe të Kishës mesjetare.

Misionarja dhe shkrimtarja Rose Lein përkthente nga anglishtja këngën e 16-të të At Gjergj Fishtës “Kulçedra”, në të cilën vargjet tregojnë për madhësinë e bukurinë e Majës së Bigës, dhe Orën e Shalës. Daniel Farlati dhe Jakob Koleti shkruajnë se: “Në token e Shalës shtrihen muret e një Gjyteti fort të lashtë. (bëhet fjalë për kështjellën e Gjytetit-shënimi im). Fusha përreth ka vada dhe asht mjaft e pjellshme e ka ajër të shëndoshë”. Në lagjen Gag gjenden muret e dy kullave dy katesh të Çun Hajdarit të Dostanishajve, të cilat janë ndërtuar rreth 215 vjet më parë, me të vetmin qellim, për mbrojtjen nga zaptuesit e huaj.

Gimajve të Shalës specifikohen të veçante në shumë drejtime. Mbi gjithçka mbizotëron një harmoni në mes të gjitha vëllaznive si askund tjetër. Kur e gjithë Shala kishte 300 burra të gatshëm për të mbrojtur trojet e veta, vetëm Gimajit kishin 100 të tilla. Një poet i shquar ka thënë:- Po të mos ishte Dukagjini, sot Shkodra do të fliste osmanisht (F.RR). Në fshatin Gag ka arritur që në një familje të ketë shtate breza, me 54 pjesëtare, që jetonin s’bashkuat, deri në mesin e viteve 60’. Ne Gimaj ndodhen dy “Monumente Natyrore” të shenjtë, nder dy shkëmbinj. Në njërin shkëmb është një kryq i madh i veteskalitur nga dora e Zotit; ndërsa në shkëmbin tjetër ka këmben e njeriut dhe quhet “Gjurma e Shenjtë”. Është interesante se, në Gimaj gjenden 63 burime uji të inventarizuara mbi të cilat ka pasur 12 mullinj. Në këtë fshat është përpunuar

zhguni (në venice), për here të pare, përpara 185 vjetëve. Në Gimaj na rezulton edhe kovaçhania e pare. Banoret e fshatit Gimajve dallohet për zgjuarsi, emancipim dhe vendosmëri, kete e deshmojne edhe personalitetet e spikatura te dale nga Gimajt. Dallohen si punetore te jashtezakonshem te cilet kane siguruar jetesen pothuajse ne cdo vend te botes ku jetojne, vetem nder Gimajt fjala dembel nuk egziston. Ne Gimaj gjendet nje i moshuar i quajtur Mhill Sokol Kerrci eshte 106 vjec lindur ne 1916. Keto vecori dhe shume te tjera do ti paraqes ne nje botim enciklopedik, me vone me titull "Gimajt e Shales". Nga trualli i Gimajve kane dale shume profesioniste te profesioneve te ndryshme, per here te pare jo vetem ne Dukagjin, Shkoder, Shqiperi por edhe ne Europe. Po permendim disa nga keto: Famullitari i pare, tezhahisti i pare, shoferi i pare, piktori i pare, botuesi i pare, drejtori i pae i gjimnazit të Shkodrës, ciklisti i pare, gjyqtari i pare, përfaqësuesja e pare e gruas, agronomi i pare, akademiku i pare, akademikja e pare, akademikja ushtarake e pare, majori i pare (drejtori i trajnimit te Gardes se Republikes, drejtoresha e pare (Porti i Durresit),inxhinierja e pare, profesori i pare, profesoresha e pare, pedagogja e pare, aktori i pare, aktorja e pare, bibliografi i pare, redaktori i pare, kordinatorja i pare, gjykatesi i pare, avokati i pare, profesori i pare ne mjekesi (drejtor i spitalit "Ulivella"- dhe docient Universiteti Federikana, kryekordinatori i mjekesise Itali-shqiperi, kryetar i diaspores Shqiperi-itali), docienti i pare (drejtori i spitalit te radiologjise, prof. i Universitetit Logaden, New York), stomatologu i pare, mundesi i pare, gazetari i pare, gazetarja e pare, publicisti i pare, kryeredaktori i pare. Ketyre profesioneve iu japim autorsine meposhte.



Kisha e Shën Rrokut, në fshatin Gimaj



Kambana e kishës së Shën Rrokut, në fshatin Gimaj



Gjovalin Biga

e tyre. Nga ana tjetër, familjaret e Tome Kole Delise-Radoja tregojnë se: "Ne kishim njohje me pjesëtarët e familjes Jashari deri 10 vjet më pare. Toma ko-

breza duke treguar zanafillën që nga brezi i parë. Djemtë e Lekës, Nika, Preka dhe Cana krijuan vllaznitë Niklekaj Preklekaj dhe Canlekaj. Pastaj vijnë nga brezi i 7-të



Armando Bobnaj, Zef Gjeta, Monsinjor Massafra, Vat Biga, Mark e Daniel Bobnaj

**VEND ME BUKURI, QË LIND NJERËZ TË MËDHENJ**

Vizitori teksa shkel token e Gimajve joshet me bukurinë magjepse të pusit të "Kole Gjonit", në lagjen Kaprre, tashme e njohur botërisht "Syri i Kaltër", rreth 480m mbi nivelin e detit. Në Gimaj duhet thënë se burimet e ujit janë nga më cilësoret, duke veçuar këtu ujin e bjeshkës së Bobnajve, për vlerat referuar analizave të gjeologeve Austriake dhe Institutit e Hidrogeologjise në Tirane. Për Gimajt janë folur e shkruar shumë legjenda. Nga ky truall i lashte kane dalë shumë figura dhe personalitete, duke u veçuar pa dyshim nga të gjitha zonat e Shqipërisë. Këto figura fale meritës dhe aftësisë së tyre janë bërë të njohur jo vetëm në vendin tonë, por edhe në Evropë e më gjere. Nga trualli i Gimajve e kanë gjenezën e tyre shumë familje famoze si Jashari, Boletini, Bala në Shkodër, Shala dhe Bala në Peje, të njohur jo vetëm në trojet e tyre të sotme, në hapësirën shqiptare, por shumë më gjere. Gjithashtu familje të spikatura si Alibali, Bala e Radoja e të tjerë janë në Shkodër. Ndërsa familjet Vatuka, Radoja e shumë të tjerë në Tirane. Janë vetëm disa nga shumë familje të dala nga ky vend, të cilat e pohojnë me krenari origjinën e tyre. Nder këto familje me shumë emër në të kaluarën dhe sot mund të veçojmë:



Vat Biga, me djalin Ilirin dhe Monsinjor Angelo Massafra



Guri me kryq natyral, në fshatin Gimaj

munikonte shpesh here me to. Dëshira e familjes Jashari për te vizituar Gimajt u mirëprit nga ana jonë, por fatkeqësisht ne tek po bëheshim gati ti prisnim, Toma ndërroi jete papritur, dhe na vjen keq se lidhjet u shkëputen".

Nipi i Isa Boletinit, Tafil Boletini personalitet i njohur për shumë dekada në Shqipëri, si Prefekt i shumë qarqeve në jug dhe në Shqipërinë e mesme, në librin voluminoz e familjes së tij me titull "Pranë Isa Boletinit & Përballe Sfidave të Kohës", tregon origjinën e shtëpisë së tyre me një pasqyrë të detajuar, në 14

Muja, Dema, Hajdari, Murseli dhe Isa (Boletini) me katër vëllezër, të cilët krijojnë brezin e 14-të.

Familja Shala:- Nga Nikushaj, larguar në Klinë, në vitin 1911, Djemtë e Ndue Syle Shalës kane vizituar së fundmi Kishën e Gimajve. Kjo familje është në pese breza me familjen e Frrok Kole Shytanit nga Nikushaj. Nga kjo familje veçojmë:

Gjon Kole Shala:- Jurist i njohur në të gjithë ish-Jugosllavinë, për 4 dekada gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatës në Prishtinë.

Prend Kole Shala:- (i vëllai) Kryetar i Partisë Demokratike për bashkësinë shqiptare të Austrisë dhe Koordinator për Evropën.

Familja Alibali, Isa (Alibali) Studiuës, shkrimtar dhe drejtor i Teatrit Migjeni për shumë vite, më tregonte origjinën e tij të largët nga Gimajt të larguar prej kohesh në Mal të Zi, atëherë me mbiemrin Bala dhe më vonë kthyer në Shkodër. Në turneun e parë të Teatrit "Migjeni" në Kosovë,-më tregonte Isaja,- kam takuar disa persona të njohur atje me mbiemrin Bala, të cilët më tregonin prejardhjen e tyre, dhe unë i quaja dhe i konsideroja si vëllezër, me disa prej tyre kam ruajtur miqësi të vazhdueshme.

Z. Zef Kripci:- (stërnipi i Qerim Delise), në shkrime, informacione dhe kënge te mbledhura me titull "Nder Malet Tona" pasqyron Pemën Gjenealogjikë të fisit të tij,-Deli Nika-1350-2008, në të cilën tregon prejardhjen që nga Zog Shiroka, si dhe duke ruajtur edhe traditën, sikurse është festimi i Shën Rrokut, në të njëjtën ditë me fshatin Shiroke. Zefi tregonte se tre vëllezërit Peroja, Ndoc, dhe Duda u vendosen në lagjet e sotme, nga cilat ato morën emërtimet Perash, Ndocaj dhe Dudas. Ndërsa nga ana tjetër z. Kujtim Bala nga familja e madhe Bala në Peje, pasi e pranon versionin e z. Zef Kripci, shton se si të parët e tij lëvizën nga Perashi në Peje dhe në vende të tjera ku edhe sot jetojnë.

Agron Bala:- Gazetar i TV shqiptar, njëkohësisht djali i Prof. Vehbi Balës, në kujtimet e tij shkruan:-"Jam shqiptar nga Shkodra, i lindur në Tiranë, me origjinë të largët nga Gimajt e Shalës. Ky është identiteti im, që as nuk e kam zgjedhur, as nuk dua ta mohoj, as nuk dua të më paragjykojnë! Zoti na dha prejardhjen, ne mund të zgjedhim vetëm të ardhmen tonë."

Nder figurat dhe personalitetet, që kane lenë emër në të kaluarën dhe sot mund të veçojmë:

-Vat Leke Shala:- Nga vllaznia e Vaçajve. Në kohen e Perandorisë Osmane përfaqësoi Sanxhakun e Shkodrës, si kryetrim, duke i dale në duel përbindëshit të quajtur "Bajloz", i cili kishte prere 99 krena njerëzish. Ai kërkonte privilegje nga me absurdet, por Vat Leka i këputi kokën në duelin, në livadhet e Bunës dhe duke i rritur Shalës lavdinë;

-Kole Marash Shala:- (1801-1863) nga vllaznia Dostanishaj. Drejtoi kryengritjen



trupores së Shna Ndout.

Surprizat në këtë festë nuk mungojnë, Pjetër Ndosh Bari dikur banor afër kishës, për të cilën kujdeseshin paraardhësit e tij i dhuroi kishës Ungjillin, botim i vitit 1864 i ruajtur fshehurazi nga regjimi i kohës.

Duhet thënë me keqardhje se për 31 vjet pushteti lokal dhe qendror nuk kane treguar thujse asnjë fare interesi për këtë fshat, për këtë krahinë.

Një gëzim i veçantë, që populli i Gimajve pas 75 vjetëve përruron kishën e saj shumë të bukur! Kisha e vjetër e Shën Rrokut filloi të ndërtohej në vitin 1929 dhe përfundoi në vitin 1931 me kontributin e vete

Gimajve. Është në kufijtë e pamundësisë që në një ngjarje të lirë, të marrin pjesë edhe një elite njerëzish me shumë dëshirë. Në gëzimin e përbashkët kishin ardhur autoritete të kishës të kryesuar nga Monsinor Angelo Massafra dhe përfaqësues nga disa kisha të vendit si dhe nga Italia, por edhe besimtare të besimeve të tjera. Merrnin pjesë personalitete të fushave të ndryshme të shkencës, artit dhe kulturës, me tituj e grada shkencore, ushtarake dhe ish ushtarake të lartë. Merrte pjesë Perfektja e Qarkut Shkodër Znj. Majlinda Angoni, drejtues dhe ish drejtues të bashkisë dhe të njësisë administrative si dhe të Qarkut Shkodër, N/Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Tonin Deda. Ishin të pranishëm kryetari i Shoqatës "Nikaj-Mertur", z. Mhill Geci si dhe anëtarë të kësaj shoqate. Merrnin pjesë, kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj, së bashku me anëtarët e kryesisë së kësaj shoqate si dhe të redaksisë së gazetës "Dukagjini".

Falënderim i veçantë ishte për autoritetet e kishës, për kontributin e dhënë për veprat e kultit si dhe për emigrantet nga vende të ndryshme të botes, ku vendi i nderit i takonte z. Vat Biga.

Mesha u mbajt nga Monsinor Massafra, i cili sapo bekoj kishën, drejtoi meshën, e cila u ndoq me një interesim të veçantë nga të pranishmit, të cilët kishin mbushur oborrin përpara kishës.


Me shumë interes u ndoq përshëndetja nga Vatikani, në të cilën shkruhej: "Ati i Shenjte i jep bekimin Apostolik të kërkuar, djalit të Dukagjinit me rastin e 80-vjetorit të tij, duke u lutur me ndërmjetësinë e Virgjëreshës së Bekuar".

\*\*\*

**Pas meshës Fr. Gazmend Tinaj ofm, famullitar i Shalës lexoi përshëndetjen për ditën e Bekimit, të cilën po e paraqesim të plote:**

Falënderimi kryesore në këtë ditë të veçantë për Famullinë e Shën Gjonit në Shalë dhe për Kishën e Shën Rrokut në Gimaj, është për Zotin, i cili na e dha mundësinë për tu bashkuar edhe një here në këtë vend. Atij i kjoftë nderi dhe lavdia, sepse nuk i ka harruar kurrë besimtarët e vet.

Dua të falënderoj Monsinor Angelo Massafren për praninë e tij në këtë ditë feste, ku bekoj kumbonen dhe kompanjelin e Kishës së Shën Rrokut, udhëhoqi meshën dhe do të vazhdojë me bekimin e Trupores së Shën Ndout, në Breg Lumi. Monsinor të falënderoj shumë, sepse na jeni gjetur afër dhe na keni ndihmuar pa mase, që në këtë ditë të Jehoje kjo kabanë, në këtë lartësi shumë të bukur të



Përshendetja e Vatikanit

fshatit Gimaj. Fale teje dhe Famullisë së Shën Françeskut të Fretërve në Castellana dhe Caritasit kemi kursyer pothuajse 650 000 leke, për zhdoganimin e kambanës. Të falënderoj në emër të gjithë kësaj famullie.

Falënderoj shumë edhe z. Giuseppe Bellucci dhe z. Antonio Bellucci, që e bënë të mundur realizimin e kësaj vepre.

Nëse ne, sot jemi në këtë Kishë, është falë ish Famullitarit të Shalës, P. Aurel Gjerkaç, ofm. Ai, në tre vite e la shenjen në çdo fshat e në çdo Kishë me përkushtime dhe me punën e tij. Nëse Kisha e Thethit është aq e bukur dhe madhështore, është pikërisht fale tij. P. Aureli, kur erdhi në këtë kishë të Shën Rrokut në Gimaj, brenda saj gjeti bagëti, kurse sot është plot me besimtare.

Falënderoj Dom Anton Kodrarin për praninë e tij dhe për përkushtime që ka pasur për përgatitjen e kësaj dite. Dom Antonin e lidhin shume gjera me këtë vend, gjaku, prejardhja e dashnia për Dukagjinin e Shalën në veçanti.

Faleminers Fr. Jak Kolgjeraj e Fr. Sergjo Jaku, bashkëvëllezërve të mi, të cilët e njohin këtë famulli në çdo lagje e shtëpi.

Falënderoj fr. Ndue Toplana, famullitar i Bajzës dhe Don Vlash Palaj, famullitar i famullisë Zoja e Shkodrës, Shkodër.

Diakonin Dom Marjan Gjinesha, që shpejt do të shugurohet meshtar, një thirrje e re, që do ti shërbejë elterit të Zotit.

Përshëndes të gjitha autoritetet lokale dhe të ardhur për këtë ditë, në veçanti Prefekten e Oarkut Shkodër Znj. Majlinda Angoni dhe N/Kryetarin e Bashkisë Shkodër, z. Tonin Deda.

Përshëndes e falënderoj nga zemra të gjithë Ju besimtare të dashur të Shalës, që jeni të bashkuar këtu sot, në mënyrë të veçantë bijtë e kësaj toke, që jetojnë në diasporë, sidomos në Amerikë. Falë tyre, sot po inaugurohen Kompamjeli dhe kambana e Kishës së Shën Rrokut në Gimaj, Truporja e Shën Ndout në Breg të Lumit.

Punimet e Kishës së Shën Gjonit në Abat, të gjitha punët përreth kishës së Gimajve, disa ura, vepra këto në dobi të

komunitetit dhe banoreve të krahinës së Shalës.

Falënderoj njërin, që në pamje duket me shtat të vogël, por me një zemër e vullnet të madh, z. Vat Bigaj, me krejt familjen e tij, me vellain-Gjovalin Biga, i cili ka paguar të gjitha shpenzimet e Kambanës. Kjo kabanë tingëlloftë për



Illir Biga merr nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, titullin "Kalorësi i urdhrit të Flamurit" dhënë për Zef Avdi Kola

të mirën tende, të familjes tende dhe të gathë atyre që kane kontribuar për këto punime, në këtë vend. Zoti jua shpërbleftë me të mira e bekime në jetën tuaj dhe të familjeve tuaja. Kambana i Kushtohet, sipas njetit të devocionit të "Gjovalin Bigës", Shën Rrokut, pajtorit të Kishës në fshatin Gimaj, Shën Gjonit, pajtorit të Famullisë së Shalës dhe Popullit të Gimajve.

Ju falënderoj shumë sepse keni harxhua shumë mund e punë.

Më lejoni të falënderoj edhe një here Vatën, i cili mendoj se tash një vit, pothuajse 6 muaj i keni shpenzua këtu. Kjo do të thotë se kane kenë shumë shpenzime, por edhe shumë punë të pabëra në vendin ku jetoni, në Amerikë. Falënderoj familjen tende, që ta kane mundësuar qëndrimin këtu.

Mirë që keni pasaportën Amerikane, sepse do ti kishe djegur dokumentet. Si-



Truporja e Shna Ndout

kur Shala të ishte Komune si dikur, unë do të beja fushatën elektorale për ju.

Në personin, z. Gjin Markaj, dua të falënderoj për zemërsisht të gjithë ata që me punën, djersen dhe shpenzimet e tyre kane bere të mundur që të rivendoset edhe një here Truporja e Shën Ndout tek elteri ku ishte dikur në Breg Lumi. Këmbëngulja juaj ka bere, që edhe një here të lartësohet Truporja e Shën Ndout në këtë vend. Kushdo të kalojë afër atij elteri do të kujtoje Shenjtin dhe Zotin. Zoti ju ndihmoftë ju dhe familjet tuaja dhe Shën Ndou ndërmjetëssoftë për ju dhe për të gjithë ata që do të ndalen për një lutje tek ai Elter.

U kërkoj ndjese, sepse për arsye kohe nuk e kam të mundur të përmend të gjithë emrat e atyre personave që kane kontribuar për me lehtësua sado pak kushtet e jetesës së shumë familjeve në kohë pandemie. Ata që kane kontribuar, në rikonstruksionin e shtëpive, urave, rrugëve, ujësjellësve dhe rikonstruksionin që do të behet në Kishën e Shën Gjonit në Abat.

Ju kërkoj ndjese, që e nuk mund të ju përmendi secilin me emër. Zot ia shpërbleftë secilit për çdo të mirë që ka bere dhe vazhdon të beje për këtë vend. Zoti ju dhashte sa ma shumë të mira.

Më lejoni t'ju them edhe një gjë: Të gjitha këto vepra nuk do të kishin asnjë kuptim nëse nuk do të fillojmë me i ndërtua një shtëpi, apo banesë të vogël Zotit tonë Jezu Krishtit, në Zemrat tona. Kjo ndërtesë ndërtohet çdo ditë, por dita e preferuar për të punuar, është e Diela. Vendi i punës është Kisha. Orarin zgjidheni ju në Kishat dhe vendet ku jetoni. Pra, mos e leni meshën e të dielës, por merrni pjesë në liturgji, duke dëgjuar Fjalën e Zotit, duke e falënderuar Zotin, duke ju lutur Atij dhe duke e marre Atë në zemër. Kështu ndërtohet Tempulli më i bukur, që nuk do të shembet kurrë.

Amen!

E gjithë kjo veprimtari u finalizua me një dreke ne lagjen Nderlyse.

**Përgatiti Mark Bobnaj, studiues, Gimaj-Shalë me 30. 4. 2022**

# DUKAGJINI, KARRELATË E SHKURTËR HISTORIKE

## Përshtëdetje në Shalë, në veprimtarinë “Shaljanët në emigrim për trojet e tyre”



Dukagjini ynë. Ky vend hyjnor i qëndisur nga Zoti dhe jo i punuar nga dora e njeriut, me një popull fisnik në doke, dhe elitër në shpirtë, me gene të pastra Ilire, trashëgimtarë të denjë të Kastriotit dhe të Nënë Terezës, në shekuj të shekujve nuk njohu mbi krye kurrkënd tjetër përveç Zotit dhe keto male, që i bekoj këto vise me burra zemërgjerë e trima që ndër mote u sakrifikuan për trojet e tyre, me martirë të fesë, që e flijuan jetën për Krishtin e Ringjallur; me nëna të përvujta dhe fisnike, me intelektual dhe akademikë të rangut të lartë shpirtëror, shkencor dhe filozofik, me pamjet plot madhni të bjeshkëve vigane, e të luginave të blerta, të thurura me vrashtësi shkëmbinjësh e malesh të thepisuna.

Historikisht ky fis i lashtë verior, qëndroi kështjellë e pamposhtur përballë stuhive dhe rrebesheve të motmoteve të ndryshme të historisë. Këto troje ende sot e kësaj dite janë bastion i lirisë së fisit arbëror, simbol i mikëpritjes tipike shqiptare, i besës së shëjtë dhe i bujarisë, e falë këtyre virtyteve të trashëguara brez mbas brezit e djallë mbas djallit, këto vise e ky popull do të jenë krenar para historisë sonë kombëtare derisa dielli i parë i nadjës të puthin ëmbël e përmallshëm krijimin. Ky shesh i bekuar, pranë Urës së Shalës, shërbeu si logu i kuvendit të burrave të urtë kapuçbardhë të maleve tona, të cilët i vetëqeverisën këto vise për shekuj me radhë sipas ligjeve të fesë së krishterë dhe normave zakonore të Kanunit, kushtetuta më vjetër në Ballkan. Ky vend i vogël mbanë në shiritin e memorieve të gjitha tallazet në të cilat jeta e përpilasi dukagjinasin gjatë shekujve. Është dëshmitar i heshtur i historisë së kësaj krahine, i qendresës dhe luftrave kundër pushtuesëve otoman, sllav, regjimi zogist dhe komunist, për të ruajtur të paprekur vlerat njerëzore dhe truallin amtar. Këto vujtje dhe sakrifica, bashkë me uratët e gjysheve tona, këngët majë krahut, tingujt e çiftelisë dhe lahutës qëndrojnë si gur themelit që do t'i rezistojë kohës e historisë i palëkundur deri në amshim. Në këtë altar të bekuem, burrat kreshnikë të Dukagjinit ndërtonin planet e qëndresës antiosmane. Këtu në verën e vitit 1806 Kuvendi i Shalës zgjodhi përfaqësinë prej 7 vetash (Shtatë Shaljanët) për tu takue me Ibrahim Pashën që kërkonte ushtarë e të dhjeta. Shtatë Shaljanët lidhën besën përpara se të takoheshin me të pabesin. Qëndresa e tyre në Saraj ishte legjendare dhe kendohet ë nderohet gjithmonë;

...Lidhi Shala besen, / Në Saraj po desim, / Veziri po dridhet, / Shala nuk po lidhet...

Ekspeditat Turke për të nështruar popullin e Dukagjinit vazhduen në vitin

1840 dhe në 1874 për kryengritësit e Dukagjinit me në krye Mark Lulën i banë që këto njësi luftatara të pësojnë disfatën e radhës.

Kongresi i Berlinit në qershor të viti 1878 kishte vendosur copimin e trojeve shqiptare. Mark Lula u vu në krye për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë si delegat me të drejta ekzekutive në Lidhen e Prizerenit bashkë me Marash Kolen e Gjokë Gegën, të cilët meritojnë të jenë të vlersuem, në altarin e kombit si të gjithë antarët e Lidhjes Shqiptare të Prizerenit. Qëndrimi i Mark Lulës fitoi simpatinë e delegateve. Gjergj Fishta në Lahutën e Malësisë thotë:

...Kur Mak Lula i pari Shalës, / Nji sy zjerm, një zog sokolit, / Burrë i zoti i pushkës e i fjalës, / Ja prët fjalën në log të kuvendit, / Se ti pashë, për Shmarrabe, / Sa per ti dalë unë zot vendit, / Me më qortue nevojë nuk ke, / Kam shkue jetën si bishë malit, / Shvesh e z bath edhe pa ngranë, / Kurr as Krajlit, e as Mretit, / Tungjatë jeta si kam thanë, / Unë kam ruejt gjuhën shqiptare, / Une kam mbajtë doke e kanu, / As për pare as për timare, / Gjakt e të parve si kam mohu....

Rezistenca antiosmane e Dukagjinit kulmohet me Luftën në Qafën e Agrit kundër ushtrisë të shumtë në numer, e drejtuar prej Komandantit të Divizionit të Shkodrës, Turgut Pasha, me forca të pajisura me artileri, me 10-24 korrik të vitit 1910. Ushtria Turke kish kaluar Qafën e Kolçit ishishin fushë në T'herme të Nikajve. Fillon rezistanca në Kodrat të Palçit prej, Salcës e drejtues nga Prel Tuli. Shala, Shoshi, Toplana, Dushmani kishin zanë pritat prej Qafës së Pejës, Qafën e Valbonës, Qafën e Ndermajës, Qafën e Agrit e deri përmbi lumin Dri.

...Me top dardhet Miter Kola, / Turgut Pasha thotë marova...

Deli Marashi i ka pri Shoshit, dhe kanë festue me armë në dorë, Natën Shqurkut, me 13 Korrik në badhë të frontit:

...Pushkën në dorë, qirat në gji, / Kanë marrë vozgat me raki, / Në dritë të hanës tuj mbushë ibriket,

Flaka e pushkëve pjekë ferlikët... / Ushtria e Turgut Pashes thye prapa me turp.

...Këtë ushtrinë e gjeneralit, / E kanë rrah me Lisa malit...

Me 28 maj 1911, në këtë shesh u mblodhën burrat e Dukagjinit, bashkë me Malësinë Madhe dhe vendosen të vazhdohej lufta kundër Turkut dhe Malit të Zi. Ndërsa Shqipëria shpallte pavarësinë në Vlorë, Shkodra ishte rrethuar prej forcave malazeze të krajl Nikollës. Sipas revistës “Hylli i Dritës”, flamuri shqiptar u ngrit në Kishën e Abatit që i bani malet të ushtojnë, “Duel Shqipnia në veti”. Në këtë periudhë Mehmet Shpendi

ishite kosolidue si patriot, luftëtar, dhe strateg me aktivitet të shumanshëm në gjitha trojet prej Shkupit deri Deçiç, në krye të Lëvizjeve për liri e për mbrojtjen e çështjes shqiptare në bashkëpunim me të gjithë figurat patriotike të kohës nënkruan memorandum me 5 pikash drejtuar fuqive të mëdha që kërkoheshin që gjuha shqipe të jenë zyrtare në 4 vilajetet. Një Dukagjin fuçi barotit ishte shqetsim për forcat malazeze në Shkodër ndaj kërkoheshin një përfaqësi për bisedime për paqe. Në verën vitin 1915 Shala caktoi Mehmet Shpendin, Çun Nikën, Marash Delinën dhe Dedë Lulashin. Gjenerali famëkeq, Rodimir Veshoviq, në pabesi nisi 1500 ushtarë dhe i vendosi në Kalinë e Dakajve. Shala e kishte orën çet. Forcat malazeze u rrethuan, u dorzuen dhe u turpëruen, këtu në këtë shesh në “Harkun e Triumfit”, kaluen nën pushkë kryq te Ura e Shales. Edhe pse rob lufte nuk u keqtrajuan por u lan të lirë të kthehen nga Qafa e Pejës. Me të marrë vesh dorzimin me turp të ushtrisë së tij Gjeneral Veshoviqi, merr peng përfaqësuesit e Shalës dhe nis një tjetër formacion ushtarak nëpër Qafë të Bëshkasit. Luftimet e rrepta fillojnë në Ndërkisa të Planit. I tërbuem për rezistencën e popullit të Dukagjinit që kish dalë në Bosh, ushtria malazeze me 15 Korrik të vitit 1915 vret në besë Mehmet Shpendin, Çun Nikën, Marash Delinën, dhe vazhdon masakrat në popullin e pambrojtun të Panit kryesisht por edhe në të gjithë Pultin e Dukagjinit, gra, pleq, fëmijë, 81 vetë u vranë, vazhduen diegjet e shtëpive dhe plaçkitjet në mbarë Dukagjinit. Edhe kësaj radhe çmimi i lirisë ishte i shtrejtë. Mbas vitit 1920 Dukagjini u rreshtue në opzitë me Fan Nolin dhe Liugj Gurakuqin. Përplasjet me forcat qeveritare në 1924, dhe 1926 që njihet si Kryengritja e Dukagjinit shkuan në ekstrem. Përfaqësuesi i Kryqit Kuq në atë kohë, Camillo Limbardi, në libri e ti, i përshkruan me dhimbje masakrat e ulta që u kryen në Dukagjin mbi popullsinë. Pavaresisht meritave që ka Mreti në krijimin e shtetit të parë shqiptar, masakrat në Dukagjin janë njollë e zezë në biografinë e tij. Në lidhje me Luftën Na-Çl, unë respektoj çdo shqiptar që mori pushkën kundër fashizmit e Nazizmit, ashtu siç përbuzi çdo shqiptar që për arsye pushtetit i ktheu pushkën shqiptarit, e lufta Jonë i kishte të dyja anët e madaljes, edhe luftën kundër okupatorit, edhe vëllavrasjen për interesa pushtetit. Lufta u përdore si trampolinë për të instaluar pushtetin e ashtuquajtur popullor, një ndër 20 diktaturat më brutale në botë, pas Lindjes së Krishtit. Kalimi i Brigadës së gjashtë në Dukagjin ishte me pak incidente. Operacionet e gjakderdhjes filluan në vitin 1945 kundër forcave të ashtuquajtura reaksionare, të cilat ishishin katilicizmi shekullor, klerikët me edukim perendimor, tradita dhe virtytet tona. Filluan vrasjet publike, arrestimet, burgimet. Njerëzit u tmerruan dhe dualen na mal, shumica prej friget, dikush për ndonjë armë. Malet u mbushen me koçakë, aq

sa edhe deputeti Dukagjinit Kol Prela i shkruente një letër Mehmet Shehut në të cilën i kërkoheshin të ndalohej dhuna e pabarshme në Dukagjin. Por, edhe Kola e kuptoi vonë se ai ishte pasagjer i ideve perendimore në trenin e lindjes, ku Beograd i ishishin drejtues i lokomotivës. Lufta e klasave, si vegla ma mizore e diktatures dhunoi të drejtat themelore njerëzore të shtresës elitare për punë, për shkollë, për punë, besim. Pader Daniel Gjeçaj, ky visar i kultures shqiptare, nuk e humbi kurrë shpresën se Krishti do të kthehej prapë në Shqipëri bashkë me lirinë. E në Pranverën e vitit 1991 thirret “Liri Democaci” do të thyenin heshtjen gjysmëshekullore, dhe Dukagjini ishte e vetmja zonë malore që do të mbështeste Opozitën e Re të dalë nga zgjedhjet e 31 Marsit të vitit 1991 duke iu bashkuar qyteteve të mëdha të Shqipërisë. Ndryshimet sociale shoqërohen me ndryshime demografike. Gati 20 000 banorë që kishte Dukagjini në vitin 1990, sot jemi të shpërndarë në të katër anët e botës, por falë përpjekjeve të gjithë dukagjinasve në Shqipëri dhe diasporë, Dukagjini qëndron në pedestal aty ku e ka vendin “Dukagjini Nderi i Kombit” për të cilën falënderoj Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, si promotore e ketij suksesi. Në aspektin kulturor falë punës së Trevës, Sofrës dhe Darkës së Dukagjinit, këngët, vallet dhe meloditë pasurojnë fondin kulturor të trevas tonë. Në aspektin historik, historianet dhe intelektualët tanë po grynjejnë çdo ditë në teme të historisë së Dukagjinit për të zbuluar xhevahiret e saj. Lambrehti thotë se, historia e botës bëhet atëherë kur të marrin pjesë shqiptaret, e unë shtoj se historia e Shqipërisë bëhet kur të marrin pjesë dukagjinasit, larg politikës e ideologjisë. Është pozitiv fakti që hapsirat që krijon një shoqëri e hapur si në Shqipëri edhe në diasporë, dukagjinasit tonë po i shfrytëzojnë me sukses në drejtim të shkollimit, studimeve, në fusha të ndryshme, biznesëve, dhe dëshirojnë që të ndihmojnë vendlindjen. Prandaj, jemi kryelartë për të kaluarën, por duke mos harruar se kemi shumë detyrime ndaj vendit ku u lindëm dhe u rritëm, sepse duke mos harruar të kaluarën mund të vlerësojmë më mirë të ardhmen dhe mund t’ju lëmë një trashëgimi të bukur vlerash njerëzore dhe shpirtërore gjeneratave të reja. T’u jemi mirënjohës të parëve tanë për emrin që na dhanë dhe për traditën që na lanë. Të mos harrojmë kullat tona legjendare me rrasa guri, unike në llojin e vet, varret e të parëve, bjeshkët tona me mrize e zana, që të mos humbim në vorbullën e zhurmshme e frenetike të metropoleve të botës. Ky tempull i shejtë, le të shërbejë si hapësirë shpirtërore lutjeje dhe kujteset, si frymëzim dhe busull orientuese për ne dhe brezat e ri dukagjinas kudo që gjallnojnë në të katër anët e botës.

Zoti e bekoftë Dukagjinit dhe dukagjinasit kudo që janë.

**Dedë Prendaj**  
*New York, 17 prill 2022*

# UBI SPIRITUS DOMINI IBI LIBERTAS

(2 Kor 3,17)



Vëllazën dhe motra, i dashun Arqipeshkvi ynë, të dashun vëllazën meshtar dhe rregulltar, të nderueme auktoritete civile dhe ushtarake, mirë se ju ka prue i madhi Zot në këto troje orë-çueta të Dukagjinit e të Shalës, që Krishti i hatroi me dhanti të shumta shpirtnore dhe natyra i bekoj me këto pamjeve plot madhni, bjeshkë vigane, lugina të blera, gjallësi lumejsh, e me kullat e bukura si tempujt e hyjnive klasike.

Unë si frat i kësaj toke, nga trangu i gjakut prej Mollës së Shoshit e nga lisi i tamblit me gjak Shalët nuk due me ju folë për historinë e Dukagjinit, për luftat me Turgut Pashen, për kryengritjen antizogiste të v. 1926, për qëndresën e thukun antikomuniste e as me u ndalë me rreshtue doket e gjalla të trashigueme brez mbas brezit; e as për gjuhën e pastër gegë të ruejtun me shumë devocion e fanatizëm; e as për përmvehtësitë antropologjike e cillësitë fizike të t'dukagjinanit; nuk due me folë as për pader Çiprian Nikën, dom Lazër Sheldinë, dom Prekë Ndreveshën, pader Danjelin, Koliqin, Palajn, Camaj-n, Kolë Prelën e Ndreke Lucën, por due me lakue e me nxjerrë në pah dimensionin shpirtnor, cillësitë fetare e vlerat e patjetërsueshme ontologjike të t'dukagjinanit.

Jena mbledhë sot me bashkënda me shoqi-shojn gëzimin e bekimit të kumbanorës së Gimajve, bekimin e trupores së Shna Ndout, inaugurimin e shumë rrugëve dhe urave të rikonstruktive, e çiljen e shtigjeve të reja; kena ardhë në këtë amfiteatër natyror prej shumë vendeve dhe krahinave të ndryshme për me festue, për me falenderue e me i dhënë lavdi Zotit, e për me thanë uratë për të gjallë e për shpirtna të t'vdekunve, që sot prej lumnis së qiellit po gëzojnë me ne, e prej amshimit po ndërmjetësojnë te i Lumi për çdo njënin prej nesh, emën për emën.

I dukagjinasi gjithmonë e ka nda gëzimin me mikun e dashamirin e është orvatë me marrë pjesë me ndjesitë më të sinqerta e më të kthejllta në dhimbtën e tjetrit, të mikut e të anmikut.

Sot, nuk na kanë mbledhë këto burra të nderuem të Shalës në SHBA që me djersë e me shumë sakrificë i kanë dhënë jetë këtyne realiteteve të bukura, me njetin e mirë për me gëzue çdo zemër dukagjinasi e me hijeshue edhe më shumë këto vise, por thjeshtë janë këne një shkëndijë e fortë për me ndëzë në zemrën tonë flakën e asaj dashunie që për shumë arsye të pashpjegueshme u shue në këto 30 vjet të demokracisë; sot, vëllazën e motra nuk na ka bashkue dëshira për turizëm e as votimet, fushatat elektorale dhe partitë politike, por dashunia për tokën e babës e të gjyshit, gjaku i të parëve, uratët e gjysheve tona, e bekimet e pader Çiprianit e pader Bernardinit, sot na ka mbledhë

tingulli i kumbonës së Kishës së Shalës që i lëshon zânin burrave të Dukagjinit për bashkim me Kishën Qiellore, sot Dukagjinit i ka pri truporja e Shna Ndout e Kryqi i Krishtit tue e drejtue edhe një herë si motit drejt shtigjeve të reja të amshimit.

Po t'kishtë këne Lekë Marashi gjallë, gëzimin e kësaj ditë do t'a kishte shprehë me këto fjalë të daluna prej thellësisë së shpirtit:

*Zotit t'madh i lutën pshtim; / Pshtim i lutën qi edhe një herë / të kersasë pushka derë – për- derë / plot hare t'tinglloj jehona / e Kishës sonë, shtëpijs s'bekueme / qi asht banesa e Perendijsë / me ja pru liri Shqipnisë / lamshit t'dheut e rodit t'nirit / nga i Lumi, i Selijsë t'Empirit. / "Si kjoftë thanë e kjoftë gjikue / i Madhi Zot e pastë premtue."*

Sot, shekullin tonë e ka mbyttë kultura e egoizmit, konsumizmit, materializmit dhe e dukjes, por këto burra me zemërganësinë e tyne na kujtuen edhe një herë fjalët e Veprave të Apostujve (Vap 2,42-47):

E ishin vazhdimisht të kujdesëshëm për ta përvetësuar mësimin e apostujve dhe nuk mungonin në mbledhjet vëllazërore, në ndarjen e bukës e në lutje.

Një frikë e madhe pushtonte çdo njeri: apostujt bënin shumë mrekulli dhe shenja të bindshme. Të gjithë ata që besuan, qëndronin së bashku dhe gjithçka kishin të përbashkët. Shitnin pronat dhe pasuritë që kishin dhe ua ndanin të gjithëve sipas nevojës së secilit. Për çdo ditë shkonin së bashku e rregullisht në Tempull, në shtëpi ndanin bukën dhe me hare e me thjeshtësi ushqeheshin së bashku. I jepnin lavdi Hyjit e mbarë populli i kishte fort për hir. Vetë Zoti çdo ditë i shtonte bashkësisë nga ata që shëlbohen.

Atëherë, vëllazën e motra shqiptar pa dallime kurfare, të dashun dukagjinasi e mijë të jemi bashkë e të coptomë bukën shpirtnore dhe atë fizike me

shoqi-shojn, të dominojmë mbi egoizmin e mbi dishirën për me u dukë: *këtë punë e bëni filani apo filani tjetër, e bëni filani prej Lotajsh apo prej Pecajsh, e bëni i biri i bajraktarit apo i vojvodës*, sepse në këtë mënyrë kena me e rifitue lirinë tonë shpirtnore e kena me ecë me dinjitet në gjurnët e të parëve nëpër shtigjet e reja – simbol i përshtegimit drejtë lumnisë së Parrizit- që ju me djersë e me mundë keni çilë në këto dy vjet.

Të parët tonë janë këne të bashkuem në gjamë e në dasëm, në log të burrave e në luftë; me shoqi-shojn kanë bashkënda gëzimin e vâjin e Shpirti i Zotit me anë të këtyne vlerave të 'unitetit shpirtnor' dhe 'bashkëndamjes së ndjenjave' ka këne i pranishëm gjithmonë ndër këto troje, e si rrjedhojë, sot këto male valviten: "Porsi fleta e Engjillit t' Zotit", madhnueshëm e të lira në realitetin e Shqipnisë e në horizontin e kupës qiellore.

Le të marrim rrugën e kthimit për Shkodër, për në USA, Itali e nëpër vendet e tjera ku banojmë me shpirtin plot, e të jemi vazhdimisht dishmitar të kësaj kulturë shpirtnore të thadrueme mbi pilastrat e 'dashunisë për njani-tjetrin' dhe 'dritës së ungjillit', sepse kjo është esenca dhe civilizimi i vërtetë i të Dukagjinanit.

Miq e dashamir, në shëj falenderimit dhe mirnjohjet për dukagjinanit tonë në emigracion, dëshiroj të përshtendë secilin prej jush me këtë poezi fort të përmallshme për Shalën, të shkrueme nga prof. Mhill Marku rreth 70 vjet më parë, të cilën e kam gjetë në korpusin e korrespondencës që prof. Mhilli ka pasë me dom Zef Shestanin e sot për sw pari po e sheh dritën e diellit:

## MALL E VÁJ

*Oh sa mall / e sa kujtime / për ty ndiej, / O Shala ime!*

*Mall për malet / që t'rrethojnë / mall për motrat / që vajtojnë;*

*mall për gurrat / që gurgullojnë, / mall për burrat / që s'të lshojnë!*

*Mall për lisat, / mall për pishat, / mall! ah mall / edhe për bishat!*

*Se ti jë / mbretësh' ndër male, / trima leve, / kreshnikë fale!*

*Qi me besë / edhe burrni / mbajtën nderin / në Shqipni.*

*Mall për ty / qi mbajte mikun / e sè lè / më ndeshë rrezikun,*

*por e mprojte / me njerzi / si kurrkund / në rrokull;*

*buk' e zemër / veç tue i qitë, / n'kamb' tu'i ndejtun / qiri ngritë.*

*Mall për vashat / shtat selvije, / floklëshueta / mbas, si hije,*

*që mbarshtojnë / punët e shpís, / përvujt'*

*q'ndisin / pajn' nusis!*

*O për ty, Shalë, / dit' e natë, / gjak me qanë / mue zemra e ngratë!*

*Si për prind / edhe kojshí, / dhe për bjeshk' / edhe për vrrí;*

*si për shokë / edhe kumarë, / dhe pr' at tokë / q'i thojshim arë!*

*O, për Kishë, / edhe për lterë, / ku na zbutej / zemra e mjerë!*

*E për vorret / në qetsí, / ku pushojnë / t'parët e mij,*

*nën hije lisash / shekullorë / ku na Zotin / lutshim prorë!*

*Oh sa djegë, / sa i vorfën jam / e sa etin / për ty e kam!*

*Kangë bariu / të ndigjoj, / Zan' e fyllit / t'a shijoj,*

*shpatin, malin / prap t'i shof, / n'fresk të pyllit / zemrën t'ngrof!*

*T'ndigjoj vajin, / t'ndigjoj gjâmën, / t'ndiej si çika / e qân nânën;*

*T'kqyr si dielli / del me hanën / n'thepa t'hjedhta / mblue me borë / n'báll të qiellit / ar-kunorë;*

*t'i kundroj / n'lumë tue notue, / t'i shijoj / rrash tue pushue! / Sa mall kam / pr' aso vetmish / tash që gjindem / mes morísh!*

*Malli zemrën / mà ka thá / vllazent t'shof / Lahut's tue i rá.*

*Kah e kndojnë / kangën madhështore / T'Oso Kukës / s'tokës Arbnore.*

*O Zot, t'lutem / me mà falë / dhe ndoi ditë / t'a kaloj në Shalë, / pse atje m'pret / thom, mue nanëshkreta, / zemërplasme / sa të jetë jeta! / Atje m'pret-o / Lokja ime / N'dnés' e váj, / ofshe e mjerime!*

*Due t'a rroku / e t'ia puti / ballin e rrudhun / faqet e vyshkme, / rravat vâjit / duert që m'rritën,*

*prehnín që m'mbajti, / gojën që m'mësoi / me dashun vendin / me durue vuejtjet, / me nderue mikun*

*me mbajtun besën, / për to me vdekun / kur t'jetë nevoja.*

*Oh, váj, o Nânë / e pse m'ke falë? / E qysh jeton / me djalë, pa djalë?*

Prof. Mhill Marku, (Shalë, 27 shtatuer 1919 – Monterey, 28 maj 1966)

Kryqi i Krishtit i drejtoftë dukagjinanit drejtë bashkimit me shoqi-shojn, drejtë lirisë shpirtnore dhe drejtë shtegut të lumnis së amshueme.

don Anton Kodrari, famullitar në Firenze (IT), Firenze, 17 prill 2022

# UDHËTIM NË SHALË - SHALJANËT NË EMIGRIM PËR VENDLINDJENE TYRE

## FOTOREPORTAZH

Një veprimtari shumë e bukur, madje mund të thuhet madhështore, në respekt dhe mbështetje të këtij grupimi, i cili po vepron fuqishëm në krahinën e Shalës të Dukagjinit, par të ndihmuar në përmirësimin e jetos së banorëve, kënaqësinë e vizitorëve, zhvillimin e turizmit, ruajtjen dhe forcimin e traditave më të mira të kësaj zone e më gjerë.

Bekimi i kumonës së Kishës së Shën Rrokut në Gimaj pati një interesim të paparë të banorëve dhe ish banorëve, por edhe të shumë e shumë tjerëve nga Shala e zonat përreth. Kurrë kjo kodër e bukur, në krah që qytetit historik të Dakajve nuk kishte parë kaq shumë njerëz dhe mjete transporti në këtë vend.

Bekimi i trupores të Shën Ndout (Shën Antoni i Padovës) në sheshin "Shtatë Shaljanët", në ballë të Urës së Shalës, kishte nxitur pjesëmarrje madhështore të qindra banorëve dhe ish banorëve shaljanë, por edhe nga Shoshi, Nikaj-Merturi, Pulti, Mirdita, e të tjera. Vargu i mjeteve të transportit kolektiv dhe atyre private ishte kaq i gjatë sa që nuk i përfshinte aparati fotografik, apo kamerat.

Shejtërimi i kësaj shtatoreje e cila u punua me përkushtim nga artisti duarartë Zef Muri, u vendos aty ku ishte vendosur shumë vite më parë, mbase, siç thuhet, që vendosur pas kthimit të delegatëve të Dukagjinit të cilët morën pjesë në ceremoninë përkujtimore, në Padova, me rastin e 700 vjetorit të shugurimit shenjt të Shën Ndout (Shën Antoni i Padovës), por që u hoq në fillimvitet 60 të shekullit të kaluar.

Vendosja dhe bekimi i trupores së këtij shenjti përkon me kohën kur për pak ditë (më 13 qershor) bëhen 790 vite i shejtërimin të tij.

-Unë përulëm me gjithë respektin dhe mirënjohjen e mundshme timen, për veprën e bijëve të Shalës të cilët mundësuan këto realizime dhe perurime, natyrisht si edhe shumë të tjerave të mëparshme.

-Respekt të thellë për vëllezërit tonë, për përkushtimin që kanë ndaj vendlindjes se tyre, dhe kjo jo për herë të parë, por prej vitesh.

-Respekt e mirënjohje për kishën dhe klerikët, e veçanërisht Ipeshkvin tonë, Monsinjon Angela Massafra, që morën pjesë me devocion dhe celebruan meshën e bënë bekimin e këtyre objekteve tashmë të shenjta.

-Respekt e mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit pa përjashtim për pjesëmarrjen masive dhe qëndrimin plot devocion gjatë ceremonive.

-Respekt për vëllezërit shoshjanë për pjesëmarrjen dhe përshëndetjen në këtë ceremoni.

-Respekt për nipat, miqtë dhe dashamirët nga Nikaj Mërturi dhe përshëndetjen e tyre.

-Respekt për miqtë dhe dashamirët nga





Pulti.

- Respekt dhe mirënjohje për Dom Anton Kodrari, Dedë Prendaj, Ndoc Ash-ta, e të tjerë, për përsëritjet e tyre të përzemërta e të thella.

-Respekt për Shoqatën "Atdhetare" Dukagjini për pjesëmarrjen dhe përsëritjet e nga zoti Ndue Sanaj.

-Respekt për të kundërdodhurën Roza Pjetri, dhe veprimtarin aktiv në këtë organizim Mark Rupa, si dhe ndaj arkitektit Zef Çuni, për projektin e bazamentit të shtatores dhe zbatimin e tij.

- Respekt për zotin Nush Gjellaj për kontributin e tij edhe në këtë rast.

-Respekt për familjen e madhe Biga, e kudogjendur dhe kurdogjendur në ndihmë për vendlindjen e saj dhe më gjërë.

- Respekt për pronarin e lokalit në Fushë të Okolit të Bogës, Gëzim Olaj, i cili të gjithë udhëtarëve, të cilët u ndalën për të pushuar aty, dhe që u ndalën të gjithë, që po shoqëronin truporen e Shna Ndout për në Shalë, i qerasi me kafe e pije të tjera dhe për të cilat nuk u mori asnjë lek.

- Dhe vjen ëmblesira në mbydhje të këtij opinjoni të shkurtër, falënderim, respekt dhe mirënjohje për zotin Gjin Markaj dhe familjen e tij, për organizimin dhe kontributin në këtë rast, por edhe të tjera të mëparshme.

"Bekuar kjosh o Shala Kreshnike!

O, vend i bekuar, ku rrita shtatin, sa shumë u lumturova sot për ty !

Behu krenare për djemtë që rrite, që po të kujtojnë e po të rinojnë çdo dite, të duan të forte, të bukur ashtu siç Zoti të fali.

Aty ku Zoti i mblodhi të gjithë jashtë bindjeve politike apo fetare, aty ku cilësia takoj vlerat, aty ku Shna Ndou u rivendos



me ndihmën e djemve tu e të Zotit !

Mirësia, fisnikëria, zemërbardhësia dhe lumtura i shoqëroftë tanë jetën familjarisht të gjithë ata që mendojnë për ty dhe të duan!", do të shkruante në një status në fb, ime shoqe, Gjystja, për atë ditë të vertetë të bekuar.

Me faqe të bardhë e në gëzime u mbledhshim gjithmonë!

Luigj Shyti, 30 prill 2022



# FALENDERIME TË PËRZEMËRTA



Shalë, Dukagjin. Parardhësit tonë sakrifikan gjithçka në emër të Zotit dhe të fesë së Krishtit, e si rrjedhojë, përgjegjësia jonë morale si bij të atyre trojeve e të atyre eterve është njimend e madhe, kështu që e lusim Zotin që të na japin hirin dhe forcën për të ecë -deri në frymen e mbrame- në gjurmët e tyre duke e lartësuar edhe më shumë -me punën dhe dëshminë tonë - emrin e Dukagjinit.

Unë nuk mund të harroj asnjëherë figurat e shenjta të Krishtit dhe të shenjtërve në arkën e vjetër të drurit të babës tim që i ruante me shumë kujdes dhe devocion, në fshetësi të plotë, nga frika se mund t'i shikonim unë, vëllezrit dhe motrat e mija, e kështu në pafajësinë tonë mund t'ju tregonim shokëve, shoqeve apo fqinjëve.

Nuk harroj kurrë festat fetare që gjithmonë festoheshin në shtëpinë tonë; im atë heqte kapuçin e bardhë dhe ruben e vjetër rreth saj, hapte dritaret e dyert e shtëpisë, na jepte qirin e dyllit të përpunuar nga duert e tij me dyllin e bletëve tona; e ndiznim, bënim kryq e puthnim dhe në fund baba duke thënë uratë me zë të ulët

Falenderojmë Zotin e gjithëpush-tetshëm që duke na ushqyer gjithmonë shpirtërisht me besim, dashuri dhe shpresë, na ndriçoj mendjen dhe zemrën, dhe njëkohësisht na krijoj mundësinë për të ndihmuar vendlindjen tonë e të Parëve tanë që motit ngulën tebanishtën e tyre në

e vendoste në mesin e sofres rrumbullake prej drurit. Ai çdo ditë pasdite, dëgjonte Radio Vatikanin, zërin e dom Zefit dhe pader Danielit që çdo ditë duke transmetuar programin në gjuhën Shqipe mundoheshin të ngushëllonin zemrat e lënduara të vëllezërvë të tyre që jetonin të izoluar nën perden e hekurt të komunizmit.

Unë u largova fizikisht nga vendlindja 21 vite më parë por asnjëherë me mendje dhe zemër, dhe këto kujtime të fëmijërisë mbetën gjithmonë të pashlyera në kujtesën time. Kështu që, në vitin 2020 kur virusi izoloi krejt botën, mendja ime natyrshëm përshtegtoi tek vendlindja ime e largët, te malet orëçueta të Shalës, te populli im i vuajtur, besimtarë, e fisnik i Dukagjinit, disa prej të cilëve -ndoshta- ndër ato ditë gjindeshin edhe pa ushqime apo ilaçe. Falenderoj të gjithë miqt e dashamirët, bashkëvuajtës, bashkudhëtarë e bashkatdhetar në mërgim që ju bashkuan nismës sime për të ndihmuar vendlindjen.

Ndihmat e para financiare ishin modeste, thjesht, vetëm për të ndihmuar e lehtësuar sadopak vuajtjet dhe mjeri-

min e shkaktuar nga virusi, Covid - 19. Falë Zotit deri në ditët e sotme bujaria e dukagjinasve që shumë e madhe dhe ndihmat u shumëfishuan, kështu që u bë e mundur rikonstruksioni i objekteve të kultit, truporia e Shna Ndout dhe rikonstruksioni i disa rrugëve dhe urave në Shalë të Dukagjinit.

Falenderojmë përzemërsisht të gjithë ata emigrantë që me punën, djersën dhe kursimet e tyre të ndershme kanë kontribuar e po vazhdojnë të kontribuojnë në ndihmë të trojeve të tyre. Falenderojmë dom Anton Kodrarin, birin e Shoshit dhe nipin e Shalës për kontributin e tij në organizimin e ceremonive fetare.

Falenderojmë administratorët dhe komisionin e ngritur në Dukagjin për organizimin dhe shpërndarjen e ndihmave financiare me korrektësi, pa dallime të asnjë natyre dhe me transparencë të plotë. Falenderojmë z. Mark Rupa, koordinator i komisionit të organizimit të dimensioneve logjistike të kësaj dite solemne dhe të paharruar për të gjithë Dukagjinast.

Zoti e bekoftë Shalën, Dukagjinin dhe mbarë Shqipërinë!

Gjin Markaj

New York, 17 prill 2022

## Poetja nga Peja, ZIZE PEPSHI, në hotel "Rozafa"!

Sot me miq artiste nga Shkodra, Malësia dhe Kosova në promovimin e dy librave me poezi te poetes nga Peja ZIZE PEPSHI. Aktiviste shoqërore në Diaspore publiciste dhe veprimtare e çështjes kombëtare Shqiptare:

"EDHE VDEKJA TURPEROHET NGA DASHURIA"

"ME JAN PËRZIER ATDHETË"

Veprimtaria promovues mbajtur në sallën e Konferencave, në hotel "Rozafa".

Përhëndetje e pare shkon për z. Ali Daci dhe z. Ismet Azizi, që po krijojnë lidhje midis artistëve nga Kosova. dhe Shqipëria

Urimi i pare për autoren e dy e librave me poezi .. zonjën Zize Pepshi

Që nga titulli librat duken ngacmues dhe të nxitin kureshtjen për ti lexuar, dhe në veçanti vlerat artistike që mbartin janë për tu vlerësuar.

Ndihem mirë, që isha pjesë e realizimit të ëndrrës të autores, për tu bashkuar me familjen e artistëve në tempullin e artit dhe kulturës Shqiptare, në Shkodër.

Faleminderit kolegeve pjesëmarrës!

Faleminderit mediave që e përcjellin këto veprimtaria poetik!

Uroj që miqtë tanë nga Kosova dhe Rozhaja të kenë mbetur të kënaqur.

Unë disa foto do publikoj si zakonisht, sepse ky është pasioni im, por bukuria e veprimtarisë nuk thuhet me foto as me fjalë

Mirë u takofshim në veprimtari të tjera!

Lulash Brigja,  
Shkodër, 7 maj 2022



# SHNA NDOU I PADOVES ZBRITI NË BREG LUMI!

- O njerëz të mirë një vepër arti merr gjithmonë emrin e autorit -

Qysh pa zbardhur e shtuna e 30 prillit të këtij moti numëror 2022 një lumë i gjatë automjetesh dhe festuesish nga oborri i Oborri i Katedrales së Shkodrës filluan procesionin e ngadalë rrugës së shumë mundimshme për në Shalë. Edhe si i ftuar edhe në detyrën time funksionale pata fatin të jem në paravijë të kësaj auto-kolone, me qëllimin e mirë të kontrollit të trafikut. Udhëtuam të gjithë së bashku me Shana Ndoun, ndaj ishte dhe do mbetet udhëtim shumë special, që nuk përsëritet më në jetën gjithsecilit. Grupi "Shaljanet në SHBA për trojet e tyre" inauguronin përfundimin e Kishës së re në fshatin Gimaj, trupores së Shana Ndout, disa urave dhe punimeve në dobi të infrastrukturës zhelamane të vendlindjes së tyre. Ishte një mëngjes i lagët me re të mugëta e cigramë pickues në segmentin Bogë-Qafe Thore, por që u çel, u buzëqesh dhe na dhuroj një ditë të bukur pranverore me diell të begatë si vetë mrekullitë e Shana Ndout. Në Bogë, te Kompleksi i Bajraktarit kafën e mëngjesit e pimë paksa në mënyrë të rrëmujshme, ashtu siç ishim të gjithë së bashku dhe vijam rrugën dredharake të Okolit të Bogës. Në qafë ndarësen mes Alpeve Perëndimore dhe lindore Shana Ndou bekoj Shkrelin dhe Shalën, të njëjtën ritual bëri dhe te Lapidari i Krajlicës Edit Durham pa hy në Theth, ndaj Kelmendit, Valbonës Currajt e Epër dhe gjithë hapësirës më madhështore të bjeshkëve shqiptare.

Ndoshta si askund tjetër nder malet tona këtu syri i njeriut, ka rastin e veçantë të shijojë puthjen e ndaluar të njomzës me borën. Një muzë e tillë hirplote lakuriqe të dehë edhe pa qenë të bën poet.

Bora sapo ka hequr vellon e sajë të mëndafshhtë, por vende-vende shkëlqen ende si shytat e vashës gjizbuluar nën rezet e diellit të argjendet. Duke ecur drejt lartësive tek-tuk nxjerrin krye kafshimet erozive dimërore të shkapërderdhura mbi asfaltin e ri, të cilave u vjen era e ndotur punë e keqe dhe korrupsion. Ani se gjithçka jo cilësore është bërë ditën për diell dhe ka përfunduar një herë e përgjithmonë në liqenin artificial të paanë të investimeve korruptive shqiptare. Sa kalon Thethin gjithsesi të asfaltuar, duke zbritur për Nderlysa të vjen optimizmi kur sheh një fillim të mirë, zgjerimi e shtrimi i segmentit Thethë -Nderlysa. Ndërsa në 6-7 km e përtejme fundore shyqyr që nuk i thyen ndonjë brinjë shtatores. Mana ajo duroj duke shtrënguar dhëmbët dhe do ishte ndier fort më rehat po ta përshkruante në këmbë ketë segment.

Gjithsesi rreth orës 11.00 mbërriti shendosh e mirë afër Blinit te Ura në Breg Lumi. Kamioni ushtarak shtuar me banderola me mbishkrimin "Shana Ndou Lutu për ne!" Dukagjin-2022 u ndal. I shumë mirëprituri i përcjellë nga shikimet dashamire të qindra e qindra syve zbriti qetë-qetë nga dhe u ngriti i hijshëm e madhështorë në panteonin e vet ngritur mbi themelin e vjetër të shembur nga dimri diktatorial. Emocione për një moment, pushtuan e drithëruan zemrat dhe

vetë malet kreshtë të argjendta mbi ne. Urime, mirë se erdhe i bekuar! Ardhsh i bardhe! Lutu për ne, u benë një më valën e kristaltë të lumit, që gurgullonte si simfoni e lumnueshme.

Shana Ndoun e shoqëruan në çdo hap tharmi i elitës intelektuale të Dukagjinit dhe i mërgatës së rikthyer nga tre konti-



Truporja e Shana Ndout dhe Ipeshkvi i Dioqezës Shkodër-Pult, Monsinjon Massafra

nente. Shana Ndou u prit ngrohtësisht dhe bujarisht nga qindra besimtare të gjitha moshave e profesioneve, nga klerikë, veprimtarë, personalitete, këngëtare, shoqata patriotike, kulturore, autoritete të pushtetit lokal dhe qendrorë.

Famullitari i Shalës Fr Gazmend Tinaj, me një të folur lakonike të ngrohtë i uroj mirëseardhjen. Më i pushtetshmi i fretërve të dioqezës Shkodër-Pult, Shkëlqesia e tij Monsinjon Angelo Massafra bekoj të bekuarin mrekullive.

Dom Anton Kodrari (frati i kësaj toke, nga trungu i gjakut prej Shoshit dhe nga lisi tamblit me gjak Shale (CITIMI IM NGA ORIGJINALI) mbajti një ligjëratë shpirtërore filozofike elokvente plot xixëllima nga e folmja leksikore e Shantonjes, Koliqit, Camaj dhe Gjeçajt. Frati ynë fshikulloi te plagët e renda shituese, si etja e pa kufi për para e pushtet, vrapimi për tu dukur, egoizmi hakmarrja dhe individualizmi ekstrem.

Dedë Prendaj ish veprimtari i lëvizjeve të para të nëntëdhjetës, ish Kryetari i parë i Komunës Shalë pas ndryshimeve demokratike përshëndeti në emër të grupit kontributor "Shaljanet në SHBA për trojet e tyre". Foli me një retorikë të lakmueshme, historie, devocioni, thjeshtësie, dashurie dhe optimizmi. Zoti Gjin Markaj menaxhues i investimeve të 7 urave të ndërtuara dhe rikonstruara ane e mbanë Shalës, Kishës së re Gimajve-së bashku me Vatë Bigën, por dhe investuesi i Trupores, që sot u lartësua njëherë e përgjithmonë në Shalë, nuk foli për vete,

por për misionin e shokëve të tij shtetgues tashmë shtetas amerikan, por të pa ndare me vendlindjen si lumi me burimin.

Përshëndetën Prefektja aktuale znj. Majlinda Angoni, Kryetaret e shqotave Nikaj Merturi Dr. Mehil Gecaj, për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"-Ndue Sanaj dhe Administratori Nj Ad Shosh-

e Shalës, nuk e di si janë ndier dje kur më se 20 automjete u bllokuan, se xhironin në baltat e segmentit rrugore në Musha. Një maskaradë e denjë për vendet më përhubura të Afrikës. Duhet të shkundemi nga romantizmi folklorik. Shana Ndou, që zbriti dje në Shalë nuk mund të shtrojë rrugën e goditur nga "raketat



Monsinjon Massafra, duke uruar mjeshtrin gurgdhendës Zef Murin, për punën që ka bërë, për ndërtimin e trupores së Shana Ndout

Ndoc Ashta.

-Askush më shkurt dhe më me modesti nuk foli se autori gdhendjes së shtatores së bekuar, skulptori Zef Muri (Shoshi). As kush më bukur, askush më mirë, dhe askush më me art nuk foli se vepra e tij. Gjithkush e pa dje veprën e tij nusërore i tha të lumtë dora! Gjithkush do shohë nder mote të njëjtin refren do përsërisë. Shana Ndou i Zef Murit zbriti në Breg Lumi si një prej shenjtorëve më me mrekullibërës të kishës katolike, por mbi të gjitha si një vepër arti e niveleve të larat, pa dyshim më e mirë daltuara nder shoqe e këtyre dy dekadave të fundit në trevën veriore.

Pas inaugurimit të kishës së re në fshatin e Gimajve dhe pas një dreke bujare rreze vaskave të burime kaltërore në Nderlysa, te bujtinat Lulash Zelna dhe Pal Zelna, vargu i procesionit mori rrugën e kthimit për Shkodër, Tiranë, Evrope dhe Amerike.

Shana Ndou i mrekullive erdhi, por ne ikëm dhe e lamë të vetmuar mes malesh të shkreta të braktisura nga bijtë e malit dhe qeveritë tona të shumë votuara dhe totalisht të dështuara. Një bukuri e adhurar nuk meriton një vetmi të tillë në një grumbull të shëmtuar rrënojash si ato të ish shtëpisë kulturës, kompleksit të dyqaneve, librisë, spitalit, PTT, Restoranti, hotelit, magazinave të konsumit, furrave të bukës, të kompleksit të repartit ushtarak, si dhe mbetjeve të përzhitura të ish Komunës së djegur nga papërgjegjshmëria. Më bënë përshtypje disa të rinj të fisit Markaj, që kishin kontribuar për Urën

ruse", që dikur e përshkonte me biçiklete Ndue Thaçina. Shana Ndou i mrekullive as grupit "Shaljanet në SHBA për trojet e tyre", nuk mund mbushin me mirësi një thes pa fund të shtjerrë në gjitha anët si yni. Shana Ndou i mrekullive as grupit "Shaljanet në SHBA për trojet e tyre" nuk mund bëjë mrekulli e të mbushin mend të mos votojmë si të lafitur për të njëjtat karrofiçina tridhjetëvjeçare inkubatorë hajdutesh serial që na kanë vjellë edhe llastiqet e tlinave.

Ringjallja e Shalës së poshtme dhe gjithë Dukagjinit nga Qafa e Kolshit deri në Shkallë logje fillon vetëm kur të ndërtohet rruga Prekal-Shosh, Vuksanaj-Lekbibaj. Kjo sfidë na përket ne që jetojmë këtu ta kërkojmë me çdo çmim politik ose për ndryshe jemi frymorë pa shpirt.

Përshëndes të gjithë ata mërgimtare shaljanë, dukagjinas dhe shqiptare që kanë mbjelle në zemrat e tyre bimën e humanizmit dhe bamirësisë për vendlindjen e tyre. Pas këtij fillimi të mirë në Breg Lumi, Shana Ndu nuk duhet lenë në vetmi, por duhet vijuar në Shosh, Pult, Nikaj-Mertur, Shllak, Temal e të tjera, me memorialë dhe vepra arti të tjera, që përka-sin personalitetet e kësaj treve, të cilat i bëjnë nderë historisë dhe që nuk bëhen dot pa ndihmën tuaj.

Vëllezër emigrant Ju paçim!

U a shtoftë Zoti pasurinë, lumturinë dhe bujarinë Tuaj!

Prele Milani

# ORA E ZËRIT

Me datën 21 maj 2022, ditë e shtune, në ora 13.00 në qytetin e Pejës, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u prezantua me Kryetarin e saj Ndue Sanaj, me konsullin e Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër-z. Gjergj Leqejza, N/kryetarin e shoqatës-z. Agron Hasanaj, N/kryetarin e shoqatës dhe shkrimtarin e vitit 2021 të Qarkut Shkodër-z. Prel Milani e poetin Lulash Brigja, dhe Shoqata Kulturore "Besa Shoshi", me kryetarin dhe këngëtarin Ndoc Fusha e rapsodin Gjon Kosteri. Morëm pjesë në një takim të veçantë nga ideja, përmbajtja e forma, të Manifestimit tradicional "Zëri i Vëllazërisë", që organizohet dhe realizohet çdo vit nga shoqata e vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj".

Ky manifestim ju kushtua vetëm letërsisë dhe kryesisht poezisë. Prandaj u quajt "Ora poetike e Zërit".

Një manifestim kulturor mbarëkombëtar me poet, artistë dhe veprimtarë nga të gjitha trojet Shqiptare Faleminderit Shoqata e "Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", Pejë, për organizimin dhe mikpritjen.

Veprimtaria u organizua në ambientet e kompleksi "Muze Kulturor - Mulliri i Haxhi Zeka", në Pejë.

Veprimtarinë, si zakonisht e drejtonte aktori i humorit Fadil Grabovci, i cili me humorin e tij, batutat e tij, veprimtaria behet dhe më tërheqëse.

Veprimtaria u hap me këngën majëkrahut, e kënduar nga dyshja simpatike, Ndoc Fusha e Gjon Kosteri, me titull "Luftë po bën Rugova e Peja" dhe në përfundim të saj e mori fjalën drejtues Fadili, i cili nxori te mikrofoni drejtuesit e pjesëmarrësve për të përshëndet. Nga ne përshëndeti Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqejza; në emër të SHAD, përshëndeti Ndue Sanaj dhe shkrimtari Prele Milani.

Përshëndeti të pranishmit, poetja, e burgosura politike në regjimin e Millosheviqit dhe ish deputetja e PDK-së të Kosovës, zonja Flora Brovina.

Përshëndeti nga Kosova Lindore, Medvegja, profesor Rexhep Abazi.

Përshëndeti nga Malësia shkrimtari Rexhep Dedushaj, Tahir Seferi nga Shkupi dhe të tjerë.

Pas përshëndetjeve, u bë promovimi i librit "Dukagjini-2012" të autoreve Luigj Shyti e Zef Lulash Sokolit. Prezantimin e tij e bëri Ndue Sanaj dhe Lulash Brigja.

Pastaj drejtimin e mori poetja Leonora Lokaj, e cila drejtoj prezantimin e poetëve, me poezitë e tyre, dhe në hapje të kësaj pjese theksoi: "Poetët janë urat që i bashkojnë edhe brigjet më të largëta të trevave tona!" Leonora ketë pjesë e hapi me poezinë e poetit Lazer Kodra (në mungesë për arsye shëndetësore), me titull "Botë Mitike", e cila u trokiste me ovacione nga të pranishmit; Prele Milani u prezantua me dy poezi, me titull "Kur jemi vetja" dhe "Dada"; ndërsa Lulashi u prezantua me poezinë, me titull "Na vranë...".

Në mes të prezantimit të poezive, këngëtar të trevave të ndryshme kënduan kënge folklorike, si Tahir Seferi nga Shkupi; këngëtar nga Peja, Besim Zabeli dhe vëllazërit Pangja.

Veprimtaria u mbyll me këngën "Moj Kosovë mriz me zana", e kënduar nga dyshja e mirënjohur Ndoc Fusha e Gjon Kosteri.

Në një dreke miqësore në ambientet e kompleksi "ERA" u ndanë disa mirënjohje për pjesëmarrësit nga shoqata "Martin Dreshaj", në mes tyre ju dha Konsullit të Nderit të Republikës së Austrisë, z. Gjergj Leqejza, Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", shoqatës Kulturore "Besa Shoshi" dhe të tjerëve.

Pas drekës, nuk mund të ktheheshim në Shkodër pa i bërë një vizite "Ujëvarës së Pejës", që me një respekt të veçantë na priti çifti Lulzim e Besnike Berdynaj, të cilët i falënderojmë.

\*\*\*

Mundësia e pjesëmarrjes sonë u realizua nga Gjergj Leqejza-Konsulli i Nderit të republikës së Austrisë në Shkodër dhe Ndoc Fusha-Kryetari i Shoqatës Kulturore "Besa-Shoshi", të cilët i urojmë: Paçin e dhënçin!

**Ndue Sanaj**



# NISMA “RRON TRADITA NË MALËSI TË MADHE” I BASHKOI SËRISH BIJTË DHE BIJAT E KËSAJ ANE

Koncerti “Folklori, pasuri që duhet mbajtur gjallë” dhe panairi “Art dhe Zej” për të parën herë veshën Koplëkun me petkun e traditës.

Pas disa javë përgatitjesh, provash, diskutimesh e mbi të gjitha emocioneve që injektojnë shpirti i garës, nën moton “Rron tradita në Malësi të Madhe” u finalizua projekti “Folklori, pasuri që duhet mbajtur gjallë”, i ideuar nga Klubi Letrar i Gjinnazit “Sherif Hoxha” Koplëk dhe i realizuar me një përkushtim të përhershëm të veçantë nga mësuesja udhëheqëse e këtij klubi znj. Merita Curri.

Me iniciativën e këtij klubi u bë e mundur që sheshi i qytetit të Koplëkut si kurrë më parë të shpallte bindshëm për publikun kostumografi, traditë, folklor, kulturë e mbi të gjitha rrijtësim të trashëgimisë kulturore ndër breza. Përkushtimi i tyre bëri të mundur mbarvajtjen e kësaj veprimtarie si dhe nxiti frymën e bashkëpunimit me Zyren Arsimore Malësi e Madhe dhe kordinimin me projektin gjithëpërfshirës të panairit “ART” dhe “ZEJE” të ndërmarrë me shkollat dhe gjinnazet e qarkut të Malësisë së Madhe.

Falë këtij “Klubi”, veçanërisht mësuese Meritës u bë e mundur të ishin të pranishëm edhe mjaft këngëtarë e rapsodë si Jonuz Delaj e Pretash Nilaj, të cilët përformuan për gjeneratat e reja pjesë nga repertori i tyre i pasur folklorik, të shoqëruar edhe me tingujt e lahutës, instrumentit të identitetit tonë me gen malësor.

Të dy këto veprimtari të sinkronizuara me njëra-tjetren sollën në ato pak orë shumë çka nga vlerat më të larta të trashëgimisë kulturore të Malësisë së Madhe, ku veç publikut të gjërë morën pjesë edhe mjaft autoritete dhe drejtues institucionesh vendore, si dhe përfaqësues nga mediat lokale e kombëtare, të cilat i dhanë vëmëndjen e merituar kësaj ngjarje.

Ajo që vlen të theksohet si mjaft e arrirë ishte materiali skenik, hartimi i të cilit ishte ilustruar me shprehje e magji fjalësh nga mësuese Merita Curri, e të interpretuara me mjaft profesionalizëm nga prezantuesi i mirënjohur nga Shkreli, Silvestër Durgaj dhe dy shoqërueset e tij, nxënëset Rigërsa Hasmujaj dhe Ankita Delaj, të cilët me dhuntinë e zërit brilant dhe paraqitjen skenike, zgjuan emocione tepër të veçanta në zemrat e të pranishmëve. Një koncert i vërtetë i realizuar me nuancat e një festivali folklorik ku dominuan veshjet e krahinës ÇAKÇIR e XHUBLETA, në të cilin, secila nga shkollat pati mundësi të performonte një material skenik folklorik, që nga kënga majë krahu e deri tek instrumentalet, ku spikati djali 10 vjeçarë nga Thethi, Emanuel Suka, i cili interpretoi mjaft bukur me lahutën e tij për të pranishmit.

Këngë, valle, elegji, ninulla, vaje, legjenda e log mejdani u pa të interpretohej nga nxënësit e Malësisë, çka bëri të frymonin edhe njëherë plot



gjallnim rrënjët dhe degët e Malësisë për identitet.

Në këtë koncert spikatën Gjinnazi i Koplëkut me këngën e besës, elegjinë për

rapsodët dhe dueli me shpatë. Gjinnazi i Bajzës me legjendën e Shpellës së Frashnit. Shkolla e Gruemirës me legjendën e “Gruas s’mirë”, por nuk mbetën pas as



shkollat e Hotit, Pjetroshanit, Tamarës etj, me paraqitjen e tyre dinjitoze.

I gërshtuar edhe me projektin arsimor “Art” dhe “Zeje” një nismë e ndërmarrë nga Drejtoria Rajonale Arsimore e Veriut me qëndër në Lezhë dhe e shtrirë si një thirrje gjithëpërfshirëse në të gjithë juridiksionin e saj, bëri që të angazhohej edhe Zyra Arsimore Malësi e Madhe, e cila pati efekt mjaft frytdhënës në angazhimin e mësuesve dhe nxënësve të shkollave të Malësisë, të cilët në shenjë solidariteti për fëmijët e Ukrainës sollën për panairin e hapur produkte nga më të ndryshmet, të punuara me art e dashuri, që nga ushqimet me gatime tradicionale e deri tek punimet e zejtarisë, si një nga degët më të vjetra të ekonomisë në Malësi të Madhe. Punime druri, guri, metali, pëlhurë, qëndistarie, lëkure etj, me qëllim shitjen dhe mbledhjen e fondeve të luftës në ndihmë të fëmijëve të Ukrainës.

Ky panair i realizuar me kushte optimale u mundësua nga kujdesi i veçantë i përgjegjës të monitorimit të kurrikulës pranë Zyres Arsimore z. Ëngjëll Kalaj, i cili në këtë aktivitet kishte edhe rolin e kordinatorit mes këtij institucioni dhe shkollave, çka mundësoi edhe promovimin e këtyre produkteve në mënyrën më të mirë të mundshme me kushte bashkohore.

Falë këtyre organizatorëve gati modest, por pasionant për punën, si kurrë më parë Koplëkun e pamë të pushtuar nga ngjyrat dhe veshjet tradicionale, të zbukuruar dhe shtruar me prodhimtari artizanale dhe të tejmbushur me malësorë të gëzuar që shijonin me ëndje gjithçka ofrohej në atë shesh të transformuar nga Rilindja Urbane, e cili mori formën e sofrës bujare që priti e përcolli bijtë e saj, me bukë e me zemër të bardhë.

Në këtë aktivitet nuk mund të mungonte prezenca dhe bashkëpunimi me Shoqatën Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” e cila mundësoi një pjesë të madhe të fondit të veshjeve origjinale të Malësisë së Madhe, për të cilën si gjithmonë nuk munguan as falenderimet.

Me urimet dhe gëzimin e mbarvajtjes së kësaj veprimtarie, organizatorët vullnetmirë mësuese Merita Curri dhe kordinatori Ëngjëll Kalaj, u kujdesen edhe për sistemimin e bazës materiale çka la të kuptohej se qytetaria dhe përgjegjësia është etikë dhe jo thjeshtë një detyrë.

Populli thotë: “Kush punon mirë ka shumë për t’u mburrur” ndaj edhe puna e tyre foli me zë të lartë për këta njerëz modest e të pa lodhur.

Rita Shkurtaç,  
20 Maj 2022

# NËSE PO KËRKON ARTEMISËN, SHKO NË DELOS, NËSE KERKO MUA KI DURIM DHE MË LEXO



Manifestimi spektakolar poetik Ora e Maleve Rrozhajë, prill 2022 më mundësoi që të njihem me dy vëllimet poetike të poetes Zize e Pepshi, por jo me autoren, e cila sot na u për shfaq për herë të pare, në këtë celebrim letrarë në zemër të Shkodrës.

Kolegu dhe mikui Ali Daci më dhuroi vëllimet "Më janë Përzier atdhetë" dhe "Edhe vdekja, turpërohet nga dashuria".

Mbi Ballinë lexova emrin Zize e Pepshi dhe i thirra të lutëm me më ndihmo oj grua cila je ti?!

Nëse po kërkoni Artemisën, shko në DELOS, nëse ke durim më lexo dhe mësoje se cila jam unë me tha çika këngëtare.

Pa ditur se ku jam vozita lakuriq sa andej -kënde ndër dallgëzimet poetike, cilët më në fund më nxorën në bregun e thepsur, ku takova orën e Pejës veshur me një mantel të purpurte poetik, dashurorë. "Më janë Përzier atdhetë" dhe "Edhe vdekja, turpërohet nga dashuria" janë dy buqetat poetike kataroshe si dy shoga

në një degë, lirika ëmbëltoje joshëse bash si shytat e vashës gjizbuluar nën rezet e diellit argjendarë të bjeshkëve të Dardanisë.

Vëllimet janë si dy motra binjake që nuk emitojnë e përsërisin shoqja-shoqen, por me motivet e tyre të larmishme plotësojnë më së miri njëra-tjetrën.

Autorja e diplomuar dhe e nusëruar për letërsi përmes Shtëpisë Botuese "Faik Konica", në Prishtinë na ka sjell një mozaik poetik që buron nga një zemër e dashuruar, për atdhetë e saj, lirinë luftuar dhe vizatuar në kujtimet poetike të demonstratave studentore të vitit 1981 apo zërit engjellorë të nënës si bekim qielor, që ndjek kudo në çdo hap!

Engjëllushë shpirt i delirë ti fluturove si dritë / Këtu kamë errësirë / Edhe pse dielli më shndritë. / Nimfën e bën këngëtare pluhuri dhe afshi tokës, që e lindi, e rriti dhe fisnikëroi

I ka hije loti në nder qerpik dhe elegjia e mërgimit shkruar me lot të vaktë malli.

Nga Dardania ime dashur / Jam larguar tash sa mot / Fort për të rrahë Zemra e shkreta / Ky mërgim më mbytë në lot.

Pasthirrma, 0 kush a trim more! - vjen si jehonë marshi luftarak kushtuar Beg Rizait dhe fatosave të atdheut, që prehen

nder varre martire në Kosovën e lirë

Aty-këtu vargjet nxjerrin xixa si stral-li gur goditet me unuer dhe zjarr kallet pena, e cila me dhimbje flakë përshkohet nga britma zemre kur kujton masakrën e Lybeniqit.

Në mermer / O zot sa tmerr / o Zot sa terr: / O Zot sa shumë emra / o zot sa shumë Zemra.

Në buzën e nektarte i mbinë lulëkuqja Mirushe arbërore. Nusen liridonë vinë ta marrin dasmore e dasmore-sha me flamur tupan e batave malet qeshin, gëzojnë e puthen nga dashnia Vargjet e Zises janë okluzione zemre, ato kanë konfigurimin e monopateve të Kollatës dhe hijeshinë alpeve zviceriane.

Rimat e tyre koloviten trimërisht jashtë censeve metriku standarde nga majat e zhveshura të horsteve dhe përfytyhen si ujëvarë në fundin grabeneve, duke krijuar melodi me tinguj bjeshke, ku muza poetik fluturon si zanë më flatra ndërmyt bjeshkës dhe fushës.

Autorja zhytur në kujtime rinore vrapon drejt majave atje kur kreshta puthen me diellin dhe syloti tyre lende ylberin.

Pa gjumë nder sy i shfaqet nder sy bjeshka, vatha e shtjerrave, te stani

bjeshkatarë ku lokja i thembiste përsesh e tambël e borë.

Gjoksin ja pushton fladi i lëndinës së blerte, ku oqiçi krifk gjate e brirë përdredhur i prinë tufës me urtësi fisnikëri.

Nga poltronin e kadifetë përbri oxhakut flakadan mes netëve të gjata dimërore zvicerane mendja dhe zemra arratisen si shigjeta dhe rrocket gryka me Bardhylin, Teutën, Pirron, Gjergjin dhe Lekën që po luajnë së bashku eposin e shqipeve.

Nder bredhishte e zabele, ku vajtojnë qyqet dhe këndojnë bilbilat atje çikika pishnajë flokë bojli i ngulet si gozhde kujtimi bash te shpella e durmës, ku djali i fali puthjen e pare. Aty i mbeten kujtimet fëmijërisë dhe puthja e pare, që i fali bashkë me pjalmim i metaforave poetike.

Po, po mana me zemër bash atje në më të dashurin vend dhe fizikisht bash, aty ku gjeti atë çfarë i mungonte atje, autores i janë përzier atdhetë

Njeri nxehtë flakareshhtë trapazan me gjamë e bubullima ku fishkëllen e pëlçet kazani dhe tjetri mermer i ftohtë shkëlqyes si bora mbi kreshtë.

Prele Milani

## Retë nukleare po mbulojnë planetin!

"E megjithatë asnjë njeri tjetër nuk ishte më modest se Ajshtajni në posedimin e fuqisë së dijes, e më i sigurtë se kjo fuqi është fatale" - Duajt Aisenhower

Ky artikull, me këtë shqetësim mbarë botëror, është botuar në gazetën "Dukagjini", nr. 169, muajin nëntor 2017, por mendojmë, që edhe me kërkesën e autorit, është koha për ta ribotuar, sepse gjendja e Luftës së Rusisë kundër Ukrainës, është një moment, që mund të pritet gjithçka, edhe lufta bërthamore. (shënim Ndue Sanaj)



Njerëz zgjohuni...! Një "Meteor Nuklear", i paparë, është "nisur" ta godasë planetin...! Është i fshehtë, dinak, tinzar, jashtëzakonisht shkatrues dhe mizor, vepër e "Djallit", sundimtarit të flakëve përvëluese të Ferrit! Shtëpia e jonë e përbashkët në prag të...!!!

Për fat të keq, ky fenomen, që i ngjan një vullkani në shpërthim, ekziston! Bota prej dekadash ndodhet jashtë kontrollit! Retë nukleare po mbulojnë planetin...!

Testi i gjashtë bërthamor i bombës me Hidrogjen H, i Koresë së Veriut, me urdhër të udhëheqësit suprem Kim Xhong-U, u krye me sukses. Forca e saj shkatruese llogaritet 1000 herë më e fuqishme se dy bombat atomike amerikane të hedhura mbi qytetet Japoneze, Hiroshima e Nagasaki, në ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore, të cilat iu moren jetën mizorisht qindra e mijëra njerëzve të pafajshëm.

Ndodhemi si para një "termeti të frik-

shëm", ku dita agon e qetë, e bukur, plot Diell e shkelqim. Udhëtojmë pa ditur se ku shkojmë?! Një urdhër i gatuar dhe i pjekur me urrejtje, tërbim, sharje e zemërim mund të shkaktojë një zjarr të përmasave globale...!

Amerikë, në zemrën e në shpirtin tënd ndodhet e sotmja dhe e ardhmja e popujve të Botës. Ju jeni shteti më i fuqishëm. Megjithatë kujdes, armët bërthamore nuk njohin superfuqi...! Ato

janë me mijëra herë më të rrezikshme e të pamëshirshme se mjaft sëmunde të pashërueshme, të cilat vrasin me miliona njerëz në vit. Angazhimi i forcave dhe i mjeteve ushtarake, jo kurdoherë jep rezultatat e kërkuara...! Përkundrazi...! Asnjëherë nuk është vonë për bisedime, qoftë edhe midis armiqve të egër, të betuar dhe të çmendur ndaj njëri-tjetrit.

Presidenti Trump: "Një sulm i mundshëm ushtarak nuk mund të përjashtohet... Më parë masat diplomatike dhe sanksionet ekonomike të Këshillit të Sigurimit të O.K.B për izolimin e plotë të Koresë së Veriut...!"

Por ajo është e armatosur me bombën me hidrogjen, e cila mund të shuajë një qytet të tërë, fjala vjen të një superfuqie, prej disa miliona banorësh...! Kundërpërgjigja, një sulm frontal i përmasave të pa parashi-

kuara ...! Pasojat... Një popull, një komb e një shtet i shkatërruar ...! Jo vetëm kaq...! Ekstremet nuk njohin kufi...!

Zotërinj të nderuar, kujdes sidomos me plagët e vjetra të luftës...! Shërimi i tyre është i gjatë dhe i vështirë. Bllokada ekonomike nuk është zgjidhja më e mirë. Ajo shton në ekstrem varfërinë, urinë, skamjen, mjerimin, urrejtjen, shuarjen e jetëve deri edhe pa lindur, dhe afron më shpejt përplasjen, luftën. Bomba me Hidrogjen e Koresë së Veriut është një rrezik i madh. Koha nuk prë! Po disa mijëra bomba atomike e me hidrogjen të superfuqive, anëtarë ose jo të Këshillit të Sigurimit, a nuk janë edhe ato një rrezik i madh, Fatalitet dhe Shpatë e Demokleut mbi kokë të Njerëzimit? Ky armatim kolosal, këto armë të shkatërrimit masiv, mund të zhdukën shumëfish herë jetën e të gjitha gjallesave të planetit tonë.

Nëse më lejohet, e konsideroj të nevojshme të kujtoj në retrospektive, një "fragment" të artikullit tim: "Të fshehtat e padukshme të Apokalipsit", botuar në gazetën *Telegraf* të datës 29 Shkurt 2012:

"Pas Luftës së Ftohtë, u duk sikur shpëtua nga katastrofa e një konfrontimi bërthamor. Por, sipas "Reuters", Presidenti amerikan Barak Obama u tha delegacioneve të 47 vendeve në Samitin Bërthamor në Uashington se, "është koha për veprime të përqëndruara globale për të frenuar humbjen e materialeve nukleare..."

Rreziku më i madh, posedimi i armëve

strategjike nga shumë shtete, të cilët, edhe njëri prej tyre, mund ta hedhin njerëzimin nën kthetrat mizore të një zjarri supërgjigjand atomik.

Superfuqitë janë të mbrojtura e të siguruar nga armët e tyre bërthamore?!

Paradoksale dhe fatale!

**(Sot Lufta e Rusisë në Ukrainë, kontraditë në mes NATO-s e Rusisë, në mes SHBA e Rusisë dhe Kinës e SHBA, për zona influencë; përpjekjet e vendeve të vogla, si Suedia e Finlanda për të bërë pjesë e NATO-s; përpjekjet e Ukrainës për të qenë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian, mund të nxitë Rusinë drejt një çmendurie, fillimin e një luftë bërthamore, pavarësisht se, dhe vetë do të jetë pjesë e saj. - shënim Ndue Sanaj)**

Beteja nukleare nuk do të kursejë askënd, as edhe vetë ata!

Po fëmijët, nipërit e stërnipërit e tyre, ku do ti çojnë? Mos vallë në planetin Mars?! Të gjithë, në një mënyrë apo një tjetër, mos herët, vonë, do të jenë pré e saj. Fundi, ç'iu duhet jeta disave, në një "oazë" nëntokësore, tej mase të vogël, në mes të një shkretëtire të pafund të djegur shkumb e hi, kur të gjithë të tjerët, qindra miliona njerëz, të jenë larguar mizorisht nga kjo botë?!

O Zot ruaje jetën mbi Tokë.

Në gjithë Universin s'ka vend më të mirë se kjo Botë...!

Luigj TEMALI

# Historia e familjes ÇEKA (SUMMA)

(Vijon nga numri 222)

## 4 AKTIVITETI PASARDHËS I FAMILJES

Familja Çeka e vazhdoi jetën e saj. Mikel Çeka u martua me një vajzë nga familja e nderuar e Shkodrës (Shiroka), Tina Palok Shiroka. Ata patën tre fëmijë: Filipin, Angjelinin dhe Gjystinën, të cilët lindën respektivisht në vitet 1898, 1900 dhe 1902.

Në një dokument dorëshkrimi në gjuhën italiane jepen disa të dhëna për familjen Mikel Çeka (Summa).

- Mikel Çeka, djali i Pjetër Summa dhe Roza Melgushi, mbajtur në pagëzim nga Pjetër Gurakuqi dhe Tereza Vladogoneja, lindur më 20 maj 1830, pagëzuar nga Dom Nikolla Valla.

- Agetina Çeka, vajza e Palok Shirokës dhe Tereza Antonia e Agostin Muzhanit, mbajtur në pagëzim nga Mikel Zef Muzhani dhe Agate Pjetër Shiroka, lindur më 9 tetor 1871, pagëzuar nga Dom Paskual Junki.

- Filip (Xhuvani, Antonio) djali i parë i Mikel Summa dhe Agetina Shiroka, mbajtur në pagëzim nga konsulli francez në Shkodër De Grand dhe Marija Berta De Grand, lindur më 20 gusht 1898, pagëzuar nga Dom Nikolla Radovani.

- Gjystina, vajza e Mikel Çekës dhe Agetina Çeka (Shiroka) mbajtur në pagëzim nga një punonjësi i konsullatës franceze Albert Loffon dhe Dava Bib Doda (motra e Prenk Pashës), lindur më 19 qershor 1900 dhe pagëzuar nga Dom Gj. Serreqi. Ajo u dorëzua murgeshë shtëpie.

- Angjelini, djali tjetër i Mikel dhe Agetina Çeka, mbajtur në pagëzim nga Mikel Topalli dhe Marije Gurakuqi, lindur më 18 korrik 1902, pagëzuar nga Dom Pjetër Gucija.

- Djali tjetër i Pjetër Çekës, Filip Çeka (Summa) ka lindur në Shkodër në vitin 1825 dhe u martua në vitin 1844 me vajzën e Gjergj Shirokës por nuk patën fëmijë. Ai vdiq në vitin 1896 nga një goditje e menjëhershme gjatë kungimit në kishën S.M.

- Djali tjetër i Pjetër Çeka (Summa), Ndoc Çeka ka lindur në Shkodër rreth vitit 1828, pati dy djem, Pjetrin dhe Lecin (1844-1900) me dy djem Tonin (1886-1936) dhe dy vajza, Rozën, martuar tek Kakariqët dhe Ninën (1885-1958) martuar me Simon Shulin (1871-1955), të cilët patën djalin Zef Shuli dhe katër vajza (Liza, Gjyljana, Gjyzepe, Luçija).

Fillip Çeka (djali i Mikel Çekës) mbaroi shkollën teknike në Shkodër dhe filloi punën si financier nga viti 1916 në Shkodër, në vitin 1918 në Durrës, në vitin 1920 në Ministrinë e Financës Tiranë deri në vitin 1922.

Më vonë, në detyrën e drejtorit të Financave në Krujë mbas vitit 1922, në Lezhë në vitet 1925-1926, në Pukë në vitet 1926-1927. Më pas vazhdoi në Vlorë si Kryesekretar Prefekturë, në Delvinë 1933-1936 nënprefekt, anë Kolonjë 1936-1938 dhe në Çamëri (Konispol) deri në vitin 1939.

Gjatë kohës që ishte në Shkodër, në vitin 1918 pas largimit të austro-hun-

garezëve dhe me ardhjen e trupave serbe më 30 tetor 1918, së bashku me Kel Koçobashin, fshehën aktet zyrtare në shtëpi qytetare të qytetit, duke bërë të mundur që asnjë material të mos binte në duart e ushtrisë serbo-malazeze.

Gjatë luftës qëndroi më tepër afër familjes në Shkodër, përveç në periudha të shkurtra mujore kur shërben si Nën-prefekt në Delvinë dhe Lushnjë, e në



Mini muzeu i familjes



Dita kur asht vendosur pllaka përkujtimore. Nga e djathta në të majtë, rreshti i parë: Zef Çuni, Xhyreh Cani, Rrustem Sykja, Adem Halili, Ndoc Kaçulini; në rreshtin e dytë: Vain Grabova, Fetije Musliu .... në rreshtin e tretë: Vili Kamsi, Mithat Dibra, Engjëll Çeka, Flora Çeka, djemtë Xhorxhi dhe Ervin Çeka, Terezina Çeka, Mikel Çeka, Zef Shuli dhe Eugen Çeka.

shtator të 1943, gjatë kohës së ardhjes së forcave gjermane në Shqipëri, bëri një akt patriotik, duke mos lejuar që qyteti i Lushnjes të digjej nga forcat gjermane.

Në vitin 1938 Filip Çeka u martua në Korçë me Marika Iljadhi, mbesa e atdhetarit Nikolla Lako, i cili ishte botanisti i parë në Shqipëri, figurë e njohur në Korçë, për të cilin Bashkia e Korçës në vitin 2017 i dha titullin "Qytetar Nderi" i Korçës për veprimtaritë e tij patriotike, shkencore dhe arsimore.

Nikolla Lako ka takuar personalisht presidentin amerikan Willson gjatë konferencës së parë në Paris, në vitet 1919-1920, ku i ka parashkruar fakte të plota për autonominë e Shqipërisë. Ai ka hartuar edhe një hartë etnografike të Shqipërisë.

Marika Çeka (Iljadhi) e datëlindjes 1910-1968, vajza e

Jorgji e Thomaidha Iljadhi, pas ardhjes në Shkodër në vitin 1957, punoi në një repart të vogël punë dore me disa gra të qytetit. Gjatë viteve të Mbretit Zog ajo u nderua me diplomë nga Enti Kombëtar "Djelmënia Shqiptare" në vitin 1931.

Ndërsa Filip Çeka në Korçë punoi si llogaritar në disa ndërmarrje të ndryshme dhe në manastirin e Kamenicës, por gjithmonë i mbikëqyruar nga sigurimi i shtetit.



Pllaka përkujtimore përpara shtëpisë

në Fushë Arrëz dhe fermën e Bushatit, prej nga doli në pension me një pension tepër minimal (nuk i quajten vite pune nëpunësit e kohës së Mbretit Zog). Jetoj deri në vitin 1975 vetëm, me djalin e tij Engjëll Çekën.

Nga martesat e Filipit me Marikën lindën dy djem Mikeli (1940) dhe Engjëlli (1944). Djali i madh, Mikeli, u martua me Terezina Toskën (Çeka) dhe kanë dy djem:

Filipin dhe Eugjenin. Filipi është martuar me Ani Çeka dhe kanë dy djem, Jonas dhe Nikolas. Ndërsa Eugjeni është martuar me Liana Çeka dhe kanë dy djem dhe një vajzë, Mikael, Kristjan dhe Barbara. Të dy djemtë, Filipi dhe Eugjeni jetojnë dhe punojnë në Gjermani. Më parë, Mikeli ka punuar me detyrë Zootehnik i Lartë në Shkodër.

Engjëll Çeka, me profesion ekonomist, ka punuar në Lezhë e Shkodër dhe në vitet 1993-2006 ka qenë kryetar i degës doganore dhe doganier në Shkodër. Jeton në Shkodër dhe është i martuar me Florinda Tef Çeka, e cila ka kryer shkollën e lartë për mësuesi. Ajo ka punuar për rreth 15 vite si mësuese muzike dhe e ciklit të ulët në Shkodër. Sot, ajo drejton kopshtin dhe shkollën private 9-vjeçare "Miqësia", objekt i ndërtuar në pronat e familjes Çeka, në afërsi të banesës që jetojnë.

Nga martesat e Engjëllit dhe Florës lindën dy djem: Gjergji, me profesion ekonomist dhe Ervini me profesion mësues. Gjergji është martuar me Zoga Guri (ekonomiste) dhe kanë dy djem Sebastianin dhe Klausin. Ervini është martuar me Luida Ujka (ekonomiste) dhe po ashtu kanë dy djem: Engelin dhe Jonasin.

Shtëpia ku jeton familja Çeka është ndërtesë mjaft solide me një vjetërsi rreth 250-vjeçare, e shpallur monument kulture në vitin 1963, kategoria I. Ajo ka vlerë historike e arkitektonike dhe është mjaft e mirëmbajtur. Shtëpia vizitohet nga shumë vizitorë të huaj dhe vendas.

Falë paraardhësve të familjes, të cilët kanë lënë mjaft pasuri, kryesisht tokë, si në Shkodër, Vrakë, Zejmen e të tjera, u krijua mundësia e ndërtimit të shkollës "Miqësia".

Në vitin 1966 i janë dhuruar Arkivit të Shtetit Shqiptar shumë dokumente, të cilat do të plotësojnë më tej historinë e familjes Çeka.

Historia e popullit shqiptar dhe veçanërisht e atij shkodran, është e mbushur me plot veprime, iniciativa dhe përkushtime ndaj çështjes kombëtare.

E në këtë histori ka luajtur rolin e saj edhe familja ÇEKA (SUMMA).

Dhoma e pritjes Varri monumental i familjes Çeka (Summa)

**Engjëll Çeka (Fundi)**



Baba im, Filip Çeka në një inagurim permendore në Erseke...Në pozicionin e N/ prefektit viti 1938



## Pamje nga Lugina e Shalës



Bar Restorant "Kreta", në Grude të Re, Shkodër, me pronar z. Tonin Mani! Ky lokal i bukur dhe bashkëkohore, me një investim nga emigracioni, që e administron Tonini, me familjen e tij. Ambient çlodhës, me lulishte dhe mobilim tradicional, që është kthyer në një pikë referimi për rininë dhe banoret e zonës.

Në raste festash, por edhe çdo fundviti aty organizohen mbremje me muzikë folklorike. Pas shumë vite pune në emigracion, Tonini dhe familja e tij vendosen të investojnë në vendlindje. Ëndrra e tij është, që të ndërtoj dhe diçka të bukur atje në fshatin e lindjes, në Kir.

Suksese z. **Tonin Mani!**

Faleminderit që kontribuon për vendlindjen dhe për gazetën "Dukagjini".

### REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**Tonin Mani**

